

Autoriteti Portual Durrës

DURRËS PORT AUTHORITY



**PLAN BIZNESI PËR ZHVILLIMIN
EKONOMIK DHE FINANCIAR
2025-2027**

- BUXHETI 2025
- PLAN BIZNESI 2025-2027

© DHJETOR 2024

Plan Biznesi për vitin 2025 dhe 3 vjecarin 2025-2027 u formësua bazuar në kërkesat dhe parashikimet e strukturave të Autoritetit Portual Durrës të cilat u trajtuan dhe vlerësuan nga drejtoria ekzekutive, bazuar në nevojat reale dhe rëndësinë për të garantuar ecurinë normale të aktivitetit të Autoritetit Portual Durrës për periudhën në vijim.

Drejtoria Ekzekutive:

**Për Divizionin e Financës dhe
Marrëdhënieve Tregtare**

Donjet Zeneli

Për Divizionin Operacional

Gerti Gega

**Për Divizionin Ligjor dhe
Administratës**

Elisa Stamo

**Për Forcën e Sigurisë Portuale
Durrës**

Alfred Velaj

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Kreshnik Bajraktari



PASQYRA E LËNDËS

1.	PËRMBLEDHJE	4
1.1	Situata makro-ekonomike dhe ndikimi në transportin detar	5
1.2	Objektivat e vitit 2025.....	6
1.2.1	Optimizimi i të ardhurave dhe ulja e shpenzimeve.....	7
1.2.2	Përmirësimi i sistemeve të sigurisë dhe sigurisë kibernetike.....	7
1.2.3	Mirëadministrimi dhe reforma rregullatore.....	8
1.2.4	Kualifikimi i personelit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	8
1.2.5	Masterplani 2030: ndërtimi i facilitetit të ri portual në Porto Romano (2025-2027)	9
2.	BUXHETI I DETAJUAR 2025.....	10
2.1	Vëllimet	10
2.1.1	Vëllimet e përpunuara në 2024.....	10
2.1.2	Parashikimi i vëllimeve për vitin 2025.....	12
2.2	Të Ardhurat	15
2.2.1	Të ardhurat nga Terminali i Trageteve	16
2.2.2	Të ardhurat nga Terminali i Konteinerëve	17
2.2.3	Të ardhurat nga Terminali i Mallrave Rifuxho	17
2.2.4	Të ardhurat nga Terminali i Mallrave Gjenerale	18
2.2.6	Të ardhurat jashtë zonave të terminaleve	19
2.3	Shpenzimet	19
2.3.1	Shpenzimet për furnizime e shërbime	20
2.3.2	Shpenzimet të tjera operative.....	21
2.3.3	Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore:.....	21
2.3.4	Shpenzime për ripagim të huave, amortizimin dhe provizione të ndryshme	22
2.4	Investimet	22
2.4.1	Investimet e reja 2025.....	23
2.4.2	Investimet që mbarten për pagesë nga viti 2024.....	24
2.5	Analiza Financiare	25
2.5.1	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	25
2.5.2	Ndarja e fitimit dhe pasqyra përmbledhëse e plan buxhetit 2025	26
3.	PLAN BIZNESI 2025-2027	27
3.1	Vëllimet.....	27
3.2	Të ardhurat	27

3.3	Shpenzimet	27
3.4	Investimet	28
3.5	Të ardhurat dhe fitimi.....	29
4.	ANEKSE.....	30
4.1	Procedura Prokurimi 1 vjecare - shpenzime.....	30
4.2	Procedura Prokurimi 3 vjecare - Shpenzime.....	32

1. PËRMBLEDHJE

Viti 2024 po vazhdon të ruajë trendin rritës në vëllimin total të mallrave të transportuara në rrugë detare, duke ndikuar pozitivisht në konsolidimin e stabilitetit ekonomik për sektorin e transportit detar dhe logjistikës në Shqipëri. Sipas të dhënave kombëtare, vetëm gjatë 9 mujorit vëllimi total I mallrave transportuar me rrugë detare është rritur me 12.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të I viti më parë, dhe peshën kryesore të kësaj rritje e mban kompleksi portual Durrës – Porto Romano nëpërmjet të cilit përpunohen 94% e totalit të mallrave transportuar me rrugë detare. Edhe pse viti 2024 ka qënë I mbushur me sfida për përpunimin e mallrave në portin e Durrësit, të ndikuara nga ngërci I krijuar në terminalin Lindor gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024 si rezultat I pretendimeve të ish-kompanisë koncesionare, porti I Durrësit ka realizuar një rritje prej 1.4% në vëllimin total të mallrave të transportuar në krahasim me një vit më parë dhe ka mbajtur peshën e përpunimit të 47% nga totali i ngarkesave në të gjitha portet shqiptare.

Një faktor ndihmues i këtyre vëllimeve tregtare ka qënë dhe qëndrueshmëria e importeve dhe eksporteve me origjinë ose destinacion Kosovën si dhe përdorimi gjithnjë e në rritje i kompleksit portual nga subjektet tregtare të Maqedonisë së Veriut.

Autoriteti Portual Durrës po përmbush planin e të ardhurave për vitin 2024, ku më konkretisht parashikohet mbyllja e vitit me një rritje prej rreth 3 % e të ardhurave krahasuar me vitin 2023, dhe realizim afërsisht sa plani.

Pavarësisht se APD nuk është ende përfitues ekonomik dhe financiar i rritjes së vëllimeve tregtare në portin ekzistues në Porto Romano, kemi siguruar një qëndrueshmëri financiare duke zbatuar përparësitë afat-mesme për një optimizim të shpenzimeve korrente dhe një mirëadministrim të shërbimeve portuale në funksion të rritje së të ardhurave.

Viti 2024 shënoi gjithashtu ecuri shumë pozitive për sa i përket zbatimit të Masterplanit 2030, duke finalizuar projektin e detajuar inxhinierik për ndërtimin e Portit të ri tregtar të APD në Porto Romano si dhe hapjen zyrtarisht të garës ndërkombëtare për zbatimin e projektit, dhe nga ana tjetër zhvillimin e portit ekzistues për qëllime turistike.

Porti i ri tregtar do mund të financohet nga Qeveria në masën 80%, ndërkohë që 20% e kostove do mund të mbulohet nga fondet e vetë APD dhe eventualisht kredimarrja. Në ligjin e miratimit të buxhetit 2025, MFE dhe MIE kanë parashikuar financimin e fazës së parë të zbatimit të Portit të ri tregtar të Durrësit në Porto romano e cila parashikon ndërtimin e infrastrukturës parësore (dallgëthyes, kanal hyrës, basen, kalata), terminalin e kontejnerëve dhe infrastrukturën mbështetëse të tij. Praelisht, APD do të sigurojë financimin e shpronësimeve, asistencës teknike për zbatimin e projektit, oponencës së pavarur dhe mbikqyrjes së punimeve si dhe detajimin inxhinierik të fazave të mëtejshme të zhvillimit të Portit duke përfshirë lidhjen hekurudhore, dhe portet e thata në Prishtinë dhe Shkup.

Ndryshime thelbësore në mënyrën e operimit gjatë vitit 2025 priten për shkak të përfundimit të kontratës 5 vjecare së shërbimit në Terminalin e Kontejnerëve në janar dhe përgatitjes dhe hapave procedurale sipas legjislacionit në fuqi për kalimin në operimin me kontratë koncesioni me afat

mbi 20 vite, dhe për këtë janë bërë parashikimet për të mundësuar një tranzicion të suksesshëm pa ndikim në operacionet në terminal.

Në këtë kontekst makro-ekonomik dhe zhvillimor drejtoria ekzekutive e APD ka përgatitur plan-buxhetin 2025 dhe plan-biznesin 2025-2027 duke u mbështetur në realizimet e treguesve ekonomiko-financiar të viteve të kaluara si dhe nevojat dhe kërkesat e Drejtorive të APD.

Ky Plan Biznes është hartuar në bazë të legjislacionit në fuqi, ku gjatë vitit mund të bëhen rishikime dhe rialokime fondesh sipas nevojave në funksion të realizimit të objektivave të APD-së duke marrë parasysh edhe performancën financiare.

1.1 Situata makro-ekonomike dhe ndikimi në transportin detar

Në përgjithësi, viti 2024 ka qenë një vit me pasiguri dhe luhatje të ndjeshme të kërkesës për transport detar për shkak të ngadalësimit të ekonomisë globale, luftës në Ukrainë, dhe sfidave të tjera makroekonomike. Nga ana tjetër, janë shfaqur mundësi të reja për rritje dhe zhvillim përmes përmirësimeve të infrastrukturës, adoptimit të teknologjive të reja dhe përshtatjen me kërkesa të diversifikuara nga tregjet e ndryshme globale.

Ashtu si gjatë vitit 2023, edhe përgjatë këtij viti situata makroekonomike globale është ndikuar nga disa faktorë kyç që kanë pasur ndikimin e tyre edhe në sektorin e transportit detar. Disa nga zhvillimet kryesore që kanë ndodhur këtë vit përfshijnë:

1. Përkeqësimi i Kushtet e Ekonomisë Globale

Në vitin 2024, ekonomia globale vazhdoi të përballlet me sfida të mëdha, përfshirë pasojat e inflacionit të lartë, rritjen e normave të interesit nga bankat qendrore dhe pasigurinë gjeopolitike që përfshin luftën në Ukrainë dhe tensionet tregtare. Ky kontekst makroekonomik ka ndikuar në uljen e kërkesës për mallra, duke sjellë si pasojë një ngadalësim të volumit të ngarkesave për transportin detar.

2. Tensionet Gjeopolitike dhe Lufta në Ukrainë

Për shkak të luftës në Ukrainë, ka pasur pengesa të mëdha në tregtinë ndërkombëtare, veçanërisht në rajonin e Detit të Zi, duke pasur ndikim në rrugët detare dhe kryesisht eksportet e grurit dhe karburanteve. Kjo ka sjellë një pasiguri në furnizimet dhe ka rritur çmimet e transportit, veçanërisht për mallrat që kalojnë përmes porteve të Europës Lindore dhe rajoneve të tjera të prekur nga ky konflikt.

3. Përmirësimi i Kërkesës për Transport Detar në Disa Rajone

Pavarësisht pasigurisë makroekonomike, kërkesa për mallra si lëndë të para dhe produkte industriale vazhdoi të mbetet relativisht e qëndrueshme në tregjet si Kina dhe India. Kjo ka sjellë një kërkesë të madhe për kontejnerë dhe anije transporti, ndonëse me çmime që mbeten luhatëse.

4. Çmimet e Naftës dhe Ndikimi në Kostot e Transportit

Rritja e çmimeve të naftës dhe pasiguria lidhur me furnizimin me energji janë faktorë që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin e transportit detar. Kjo ka rritur kostot operationale të anijeve dhe ka ndikuar në çmimet e transportit të mallrave. Po ashtu, janë bërë përpjekje për të ulur emetimet e karbonit në sektorin detar, duke i shtyrë linjat detare të investojnë në teknologji të pastra, një tjetër faktor që ka ndikuar në rritjen e kostove.

5. Teknologjia dhe Rregulloret e Mjedisit

Rregulloret ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, si ato të Organizatës Ndërkombëtare të Transportit Detar (IMO), kanë ndikuar gjithashtu në zhvillimin e transportit detar. Këto rregullore kanë kërkuar që linjat detare të reduktojnë emetimet e gazrave serrë, duke shtuar investimet në teknologji më të pastra dhe anije më efikase në përdorim të karburanteve. Ky kalim ka pasur një ndikim të ndjeshëm në shpenzimet dhe efikasitetin operativ.

6. Transformimi i Zinxhirëve të Furnizimit

Për shkak të pasigurisë ekonomike dhe ndërprerjeve të mëdha që ndodhën si rezultat i luftës në Ukrainë, shumë kompani kanë filluar të rivlerësojnë zinxhirët e tyre të furnizimit dhe kanë kërkuar diversifikim të rrugëve dhe metodave të transportit. Ky trend ka çuar në një rritje të përdorimit të porteve të tjera detare, duke hapur rrugën për më shumë fleksibilitet në proceset e transportit dhe shkarkimit të mallrave.

7. Përmirësimi i Infrastruktura dhe Investimet në Transportin Detar

Pavarësisht sfidave, shumë shtete kanë vazhduar të investojnë në përmirësimin e infrastrukturës detare. Ky trend ka sjellë rritjen e kapaciteteve të porteve dhe një rritje të efikasitetit të transportit. Po ashtu, ka pasur një rritje të interesit për ndërtimin e anijeve me kapacitet të lartë dhe me emetim të reduktuar të karbonit.

Vendet e Ballkanit Perëndimor ku bën pjesë edhe Shqipëria, janë përballur me të njëjtat sfida makroekonomike gjatë vitit 2024, përfshirë inflacionin e lartë, pasigurinë politike dhe zhvillimet globale që kanë ndikuar në kërkesën e jashtme. Megjithatë, rritja e mundshme e investimeve të huaja dhe ecuria për të integruar këto vende në Bashkimin Europian kanë ofruar mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm në rajon. Rritja e sektorëve si turizmi, infrastruktura dhe shërbimet janë sektorët kyç që kanë kontribuar në projeksionet e rritjes ekonomike duke i bërë më të larta se vendet e Evropës perëndimore, por sigurisht kjo sjell përballjen me sfida të mëdha për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm.

1.2 Objektivat e vitit 2025

Ekonomia shqiptare, referuar shkëmbimeve tregtare, mbetet e lidhur ngushtë me ato të ekonomive të rajonit (Itali, Greqi, etj) dhe zgjerimi ekonomik shqiptar ndikohet nga vendet e rajonit. Sektori i Turizmit parashikohet të vijojë të ketë një ndikim pozitiv në ekonominë shqiptare edhe në vitin 2025.

Rritja ekonomike në Shqipëri parashikohet të jetë rreth 3% edhe gjatë vitit 2025 por rreziqet kryesore nga situata makroekonomike, orienton drejt modeleve konservatore të parashikimit në vëllime tregtare dhe në të ardhura.

Më konkretisht, pavarësisht se kompleksi portual Durrës – Porto Romano ka njohur vëllime me rritje të qëndrueshme në vitet e fundit, kjo nuk është reflektuar në rritje të njëtrajtshme të të ardhurave për institucionet shtetërore (MIE/APD). Kjo për dy arsye:

- Nga njëra anë politikat tarifore që kemi ndjekur kanë synuar mos të ndjekin presionin inflacionist të faktorëve të lartpërmëndur,
- Nga ana tjetër, operimi i kompleksit portual i organizuar me Mallrat gjenerale, rifuxho, Kontejnerët dhe Tragetet në Durrës, dhe Mallrat rifuxhio të lëngshme dhe të thata në Porto Romano nuk është shoqëruar ende me rishikim të tarifave në favor të autoriteteve kontraktore.

Për këtë arsye gjatë vitit 2025, mbështetur në kuadrin e ri ligjor për zhvillimin e faciliteteve portuale në Porto Romano, APD do synojë që të realizojë një harmonizim dhe një optimizim të ri të tarifave portuale për të rritur konkurrueshmërinë dhe përfitueshmërinë në favor të enteve publike.

Në këtë kontekst, drejtoria ekzekutive i paraqet për miratim Këshillit Drejtues buxhetin për vitin 2025, buxhet i cili synon të jetësojë objektivat afatmesme:

- Optimizimi i të ardhurave dhe ulja e shpenzimeve operative;
- Zbatimi i Masterplanit 2030: vijimi i ndërtimit të Ballinës ujore - Marina e Durrësit dhe nisja e ndërtimit të Portit të ri tregtar në Porto Romano;
- Reforma e administrimit portual dhe harmonizimi i tarifave;
- Konsolidimi i sigurisë portuale dhe kibernetike;
- Kualifikimi i personelit, inovacioni dhe bashkëpunimi ndërkombëtar;

Është e rëndësishme të theksojmë se të gjitha këto përparësi vihen në funksion të jetësimit të objektivit parësor të APD: jetësimi i Masterplanit 2030, të një Autoriteti Portual Durrës me dy porte: një Port-Hub logjistik në Porto Romano dhe një Port turistik në Durrës.

1.2.1 Optimizimi i të ardhurave dhe ulja e shpenzimeve

Në vitin 2022 APD vendosi si objektiv përmirësimin e raportit shpenzime/të ardhura duke synuar uljen e tij me 2 pikë përqindjeje deri në 2023. Në vijimësi ky qëllim është arritur dhe tejkaluar: nga një raport 98,7% në vitin 2022 jemi tashmë në një raport 95.9% për fund-vitin 2024 duke synuar për vitin 2025 një raport edhe më të theksuar prej 86.3%.

Rritja e konkurrencës nga terminali privat në Porto Romano për mallrat gjenerale, rifuxhio, i importimit të automjeteve destinuar për transport individual me linja ro-ro si dhe linjave ajrore loë-cost, na detyron të bëjmë një parashikim pa rritje thelbësore në të ardhurat e përgjithshme për vitin 2025. Për këtë arsye jemi treguar shumë të kujdesshëm duke u fokusuar kryesisht në parashikimin e shpenzimeve thelbësore për të propozuar një ulje të shpenzimeve jo vetëm në raport me planin 2024 por gjithashtu në raport me faktin 2024.

1.2.2 Përmirësimi i sistemeve të sigurisë dhe sigurisë kibernetike

APD duhet të përforcojë masat mbrojtëse dhe procedurat parandaluese sipas një koncepti të sigurisë totale në spektrin fizik, teknik dhe kibernetik. Siguria Portuale mbetet një përparësi e APD duke synuar një facilitet portual edhe më të sigurt, përkundrejt sfidave të mëdha që paraqesin trafiqet, aktivitetet e paligjshme, klandestinët apo dhe siguria fizike e anijeve dhe ngarkesave.

Në periudhën 2025-2027 APD do të vijojë me zbatimin e strategjisë së integruar të sigurisë portuale në bashkëpunim të ngushtë me Policinë Kufitare, Doganat, Drejtorinë Detare dhe agjencitë e tjera ligj-zbatuese.

Gjithashtu në mbështetje të strategjisë afatmesme dhe me mbështetjen e AKCESK dhe MIE, APD do të vazhdojë të ndërmarrë në vitin 2025 hapa të mëtejshëm për sa i përket mbrojtjes kibernetike.

1.2.3 Mirëadministrimi dhe reforma rregullatore

Përgjatë vitit 2025, zhvillimet transformuese për infrastrukturën dhe sektorin portual në kompleksin Durrës – Porto Romano, dhe në funksion të statutit të ri të Autoritetit Portual Durrës të miratuar në vitin 2024, do duhet të shoqërohen dhe nga një reformë rregullatore sipas modelit 1 Autoritet 2 porte, duke shtrirë kompetencat e APD edhe në zonat portuale në Porto Romano, duke vendosur nën ombrellën e Autoritetit Portual tërësinë e aktivitetit portual aktualisht në operim në këtë zonë, dhe duke monitoruar marrëveshjet ekzistuese në Porto Romano nga këndvështrimi i të drejtave dhe përgjegjësisë të operatorëve portualë, veçanërisht për sa i përket zhvillimit të infrastrukturës, politikave tarifore dhe përgjegjësisë mjedisore.

1.2.4 Kualifikimi i personelit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Përmes CEMA, APD do të vijojë programet e saj lidhur me:

- a. Bashkëpunimin ndërkombëtar që APD ka me organizata rajonale dhe Evropiane apo dhe me autoritete të tjera portuale në Europë, duke evidentuar veçanërisht: Sekretariatit rajonal të Transportit, IMO, ESPO, HAROPA – Le Havre, Port of Antwerpen-Bruges, DG Move pranë Komisionit Evropian, EMSA.
- b. Trajnim dhe kualifikim i punonjësve brenda dhe jashtë vendit duke vecuar rëndësinë e kualifikimit:
 - Të personelit operativ për vinçat dhe auto-mekanizmat,
 - Të personelit të sigurisë,
 - Të personelit menaxherial,
- c. Trajnimin e palëve të treta: CEMA do mund të gjenerojë të ardhura përmes trajnimeve dhe kualifikimeve për palët e treta në kuadër të liçensave ekzistuese që APD ka me autorizim të MFE.
- d. Kërkimin shkencor në bashkëpunim me Universitetin e Durrësit, Akademinë e Sigurisë dhe Akademinë e Forcave të Armatosura si dhe këshillimin pranë MIE për sa i përket reformës së Administrimit detar dhe portual në përputhje me procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.
- e. Inovacionin dhe dixhitalizimin e shërbimeve portuale përmes partneritetit me institucione vendase dhe të huaja dhe krijimin e një qendre të inovacionit portual në mbështetje të start-up që ofrojnë shërbime për operatorët portualë.

1.2.5 Masterplani 2030: ndërtimi i facilitetit të ri portual në Porto Romano (2025-2027)

Sa më sipër, të gjitha këto objektiva, në kuadër të përpilimit të projekt- buxhetit 2025, dhe të plan biznesit 2025-2027 vihen në funksion të jetësimit të Masterplanit 2030: drejt krijimit të një Porti-Hub logjistik në Porto Romano dhe një Porti turistik në Durrës i cili parashikon:

- Krijimin e një Kompleksi Portual Durrës – Porto Romano si porta hyrëse dhe nyja logjistike e Europës Adritiko - Joniane, veçanërisht për shtetet kufitare, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut.
- Ndërtimi i terminaleve logjistike në tokë nga Autoriteti Portual në funksion të rritjes së volumeve tregtare dhe ulje të kostove të transportit rajonal dhe vendas, veçanërisht në Kosovë (Prishtinë) dhe në Maqedoninë e Veriut (Shkup),
- Ndërtimi i një faciliteti të ri ushtarak për Forcën tonë detare dhe forcat aleate në bashkëpunim me NATO-n;
- Përdorimi i portit historik të Durrësit në funksion të turizmit dhe shërbimeve detare elitare,
- Rishikimi i modeleve të administrimit të Porteve tregtare, sipas praktikave më të mira Europiane të menaxhimit të integruar, në funksion të rritjes së të ardhurave publike dhe të mirave publike nga sektori i transportit detar,
- Integrimi i kompleksit portual Durrës-Porto Romano në nyjet kyçe të transportit të Bashkimit Evropian.

Për këtë arsye, 99% e vlerës totale të investimeve të reja për vitin 2025, është e dedikuar për zbatimin e Masterplanit APD 2030, ku 96.6 % janë investime për fillimin e punimeve të Lotit të parë të ndërtimit të facilitetit portual në Porto Romano falë mbështetjes buxhetore të Qeverisë shqiptare në masën 14.745 mld lekë për vitin 2025 dhe 3.4% e vlerës përfshin kostot e shpronësimeve, lejet dhe autorizimet, oponencën dhe asistencën teknike, supervizimin dhe kolaudimin e punimeve që do mbulohen nga APD. Për më shumë detaje lidhur me këtë komponent të rëndësishëm lutem referojuni tabelave në relacionin e investimeve për vitin 2025 dhe parashikimeve për periudhën 2025-2027.

2. BUXHETI I DETAJUAR 2025

Në vijim do të paraqitet buxheti I detajuar propozuar për vitin 2025 me analizën e volumeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, detajim për blerjet dhe investimet si dhe një analizë mbi rezultatin e pritshëm financiar. Për efekt te leximit të të dhënave në vijim, të gjitha vlerat monetare janë shprehur në lekë dhe vëllimet në ton (përvec rasteve ku është cituar ndryshe).

2.1 Vëllimet

2.1.1 Vëllimet e përpunuara në 2024

Në krahasim me planin, gjatë 11 mujorit të parë të 2024 ka patur një rritje në vëllimin e mallrave rifuxho me 40% dhe mallrave të transportuara nëpërmjet linjave të trageteve me 4%. Rritje gjithashtu ka patur përpunimit i njëjësive konteinerike (TEU) në Terminalin e Konteinerëve me 2%, por nga ana tjetër ka patur një rënie peshë totale e mallrave të transportuara me konteinerë me 8%, si rezultat edhe i shfrytëzimit më të shumtë të konteinerëve 40' (2 TEU) në dallim nga ato 20' (1 TEU) nga transportuesit. Rënie ka pësuar edhe vëllimi i mallrave gjenerale me 14%. Kjo ka bërë që gjatë 11-mujorit të parë të vitit 2024 të ketë një realizim të vëllimit të mallrave të përpunuar afër pritshmërive, duke arritur në masën 97% krahasuar me planin.

Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 vëllimet e realizuara kanë ardhur në rritje me një ndryshim prej 1 % në peshë mallrash, 8% në numër njësi konteinerike por me një rënie prej 7% në numër pasagjerësh dhe 1 % në numër mjetesh transportuar me traget, për shkak të përdorimit të shtuar të linjave ajrore loë-cost. Këto të dhëna krahasimore janë pasqyruar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1: Janar-Nëntor 2024 krahasuar me planin


Terminali	Plani Janar -Nëntor 2024	Fakt Janar -Nëntor 2024	Diferenca ne vlere	Realizimi ne % krahasuar me Planin
I Mallrave Gjenerale	285,410	246,120	(39,290)	86%
I Mallrave Rifuxho	186,993	262,311	75,318	140%
I Konteinerëve	2,036,141	1,865,458	(170,683)	92%
I Trageteve	915,997	949,052	33,055	104%
TOTALI (TON)	3,424,542	3,322,941	(101,601)	97%
Konteinerët (Në Teu)	179,118	182,534	3,416	102%
Pasagjerët (Nr)	750,447	716,214	(34,233)	95%
Mjete me traget (Nr)	254,429	263,458	9,029	104%

Tabela 2: Fakti 2024 krahasuar me faktin 2023

Terminali	Fakt Janar -Nëntor 2024	Fakt Janar - Nëntor 2023	Diferenca ne vlere	Ndryshimi fakt 2024-2023 ne %
I Mallrave Gjenerale	246,120	230,003	16,117	107%
I Mallrave Rifuxho	262,311	235,653	26,658	111%
I Konteinerëve	1,865,458	1,894,425	(28,967)	98%
I Trageteve	949,052	917,226	31,826	103%
TOTALI (TON)	3,322,941	3,277,307	45,634	101%
Konteinerët në TEU	182,534	169,781	12,753	108%
Pasagjerët (Nr)	716,214	768,807	(52,593)	93%
Mjete me traget (Nr)	263,458	264,981	(1,523)	99%

Në analizën e të dhënave mbi drejtimin e qarkullimit të mallrave rezulton që importi edhe gjatë vitit 2024 vazhdon dominojë aktivitetin tregtar portual. Vihet re një ruajtje e raporteve Export Import, në masën 1/3 me 2/3.

Grafiku 1: Raporti Import Eksport 2022-2023



Mallrat e importit që kanë patur më shumë rënie të volumeve janë Qymyri, Klinkeri rifuxho dhe skrapit rifuxho. Për 2 të parat nuk ka patur fare import gjatë këtij viti. Rritje vëllimesh ka patur në materialet e ndërtimit, si hekur dhe cimento.

Nga mallrat e eksportit më shumë rënie të vëllimeve të përpunuara shihet te Kromi rifuxho. Ndërsa është rritur eksporti i cimentos dhe skrapit rifuxho.

Tabela 3: Mallrat në Import (luhatjet e volumeve)

Lloji I mallit	Janar - Nentor 2024	Janar - Nentor 2023	Diferenca
Cimento rif kalate	12,332	2,970	9,362
Hekur	63,275	7,722	55,553
Llamarine, prokate	24,765	10,218	14,547
Qymyr rif.	-	13,973	(13,973)
Skrap rif	2,307	13,636	(11,329)
Klinker rif	-	10,300	(10,300)

Tabela 4: Mallrat në eksport (luhatjet e volumeve)

Lloji I mallit	Janar - Nentor 2024	Janar - Nentor 2023	Diferenca
Skrap rif	23,484	13,028	10,457
Cimento rif	123,200	90,472	32,728
Krom rif	2,563	45,347	(42,784)
Generale rif	-	6,298	(6,298)

2.1.2 Parashikimi i vëllimeve për vitin 2025

Shërbimet që ofrohen në portin e Durrësit janë të përqëndruara në funksion të operacioneve të ngarkim/shkarkimit të mallrave, (gjenerale,rifuxho dhe ato nëpër konteinerë), operacionet për lëvizjen normale të pasagjerëve dhe mjeteve nga dhe drejt Italisë. Shërbimet e të tjera mbështetëse janë gjithmonë në funksion të operacioneve kryesore të përmendura më lart.

Autoriteti Portual Durrës objektin e aktivitetit e ka si LandLord Port dhe nën këtë përcaktim operacionet e përpunimit në терминаlet e portit janë kaluar tek operatorët privatë. Kështu në Terminalin e Mallrave Rifuxho (Terminali Lindor) operon konçesionari EMS-APO, në Terminalin e Trageteve operon konçesionari AFTO. Terminali i Konteinerëve operohet aktualisht nga një subjekt privat nëpërmjet një kontrate shërbimi e cila është në përfundim dhe gjatë vitit 2025 pritet kalimi në operim më kontratë konçesionare, ndërsa Terminali i Mallrave Gjenerale (Terminali Perëndimor) menaxhohet nga APD por operacionet e ngarkim shkarkimit kryhen nga kompanitë stivadore sipas kontratave përkatëse. Gjatë vitit 2023 APD ka krijuar një strukturë operacionale që përpunon konteinerët e ngarkuar me automjete të destinuar për shitje, e cila funksionon si terminal i diferencuar nga Terminali i Konteinerëve.

Parashikimet e volumeve për vitin 2025 pritet të jenë si vijon;

- Në Terminalin e Mallrave Gjenerale parashikimi i rritjes vjetore për vitin 2024 me mbi 18% me synimin për ta cuar përpunimin në nivelet e vitit 2022 nuk u realizua. Për vitin 2025 kemi parashikuar që vëllimet për vitin 2025 të vazhdojnë me një rritje të moderuar prej 6%, duke ndjekur trendin i realizuar gjatë vitit 2024 në krahasim me vitin 2023.
- Në Terminalin e Trageteve parashikohet që vëllimet të jenë të ngjashme me vitin 2024 me supozimin që lëvizja dhe orientimi i pasagjerëve mes transportit detar dhe ajror është stabilizuar.
- Në Terminalin e Mallrave Rifuxho për vitin 2024 ishte parashikuar rënie e volumeve të punës duke ndjekur tendencën e viteve paraardhëse por dhe si rezultat i konfliktit me ish operatorin konçesionar. Kjo rënie u evidentua gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024, por me ndryshimin e aksionerëve të kompanisë konçesionare dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, vëllimet njohën një rritje të theksuar duke tejkaluar me 40% mbi planin e vitit. Gjatë vitit 2025 kjo rritje pritet që stabilizohet, për këtë arsye kemi parashikuar një vëllim të moderuar me 4% më të lartë se vëllimet e pritshme për vitin 2024.
- Në Terminalin e Konteinerëve parashikohet një nivel i ngjashëm i vëllimeve edhe gjatë vitit 2025 krahasuar ndikuar edhe nga fakti që ky terminal është shumë afër kapacitetit maksimal të përpunimit. Ky parashikim u ndikua dhe si rezultat i mos arritjes së parashikimeve për vitin 2024.

- Terminali Auto: Pas pandemisë pati një rritje të kërkesave të tregut për automjete të importuara nga përtej oqeanit nëpërmjet anijeve konteinerike. Kjo rritje arriti pikun gjatë vitit 2023, ku u pa e udhës që APD të krijonte një strukturë e cila u specializua vetëm me përpunimin e këtyre konteinerëve të ngarkuar me mjete. Gjatë 6 mujorit të parë të 2024, me futjen e një linje Ro-Ro që operon në portin privat në Porto Romano, një pjesë e këtij vëllimi filloi të ndahet mes 2 porteve duke sjellë një realizim prej 85% në krahasim planin. Rënie më e stabilizuar parashikohet të vazhdojë edhe përgjatë vitit 2025 në masën 5% krahasim me pritshmëritë e vitit 2024

Tabela 5: Vëllimet e detajuara


Shërbimet	Njësia e matjes	Volumet					
		2023	2024			2025	
			Plan	I pritshmi	%	Plan	%
Mallra	Ton	a	b	c	d=c/b	e	f=e/c
Eksport me anije Rifuxho	"	174,939	134,774	163,982	122%	170,541	104.0%
Import me anije Rifuxho	"	78,944	65,939	116,952	177%	121,630	104.0%
Totali Eks/ Imp Rifuxho	"	253,883	200,713	280,934	140%	292,171	104.0%
Eksport me anije Gjenerale	"	-	1,933	-	0%	-	
Import me anije Gjenerale	"	252,518	308,913	268,202	87%	285,900	106.6%
Totali Eks/Imp Gjenerale	"	252,518	310,845	268,202	86%	285,900	106.6%
Eksport me tragete	"	385,247	391,839	370,559	95%	370,559	100.0%
Import me tragete	"	612,241	605,631	663,339	110%	663,339	100.0%
Totali Eks/Imp Tragete	"	997,488	997,470	1,033,898	104%	1,033,898	100.0%
Eksport me kontenier	"	732,206	778,543	746,896	96%	746,896	100.0%
Import me kontenier	"	1,336,358	1,445,524	1,291,317	89%	1,291,317	100.0%
Totali Eks/Imp Konteiner	"	2,068,564	2,224,068	2,038,213	92%	2,038,213	100.0%
Totali eksport	"	1,292,392	1,307,089	1,281,437	98%	1,287,996	100.5%
Totali import	"	2,280,061	2,426,007	2,339,810	96%	2,362,186	101.0%
TOTALI	"	3,572,453	3,733,096	3,621,247	97%	3,650,182	100.8%
Kontenierë	TEU						
Eksport	"	91,917	94,884	88,865	94%	88,865	100.0%
Import	"	92,100	98,943	90,082	91%	90,082	100.0%
TOTALI	"	184,017	193,827	178,947	92%	178,947	100.0%
Pasagjerë	Numër						
Dalje	"	418,013	416,223	393,769	95%	393,769	100.0%
Hyrje	"	409,839	402,447	378,266	94%	378,266	100.0%
TOTALI	"	827,852	818,670	772,035	94%	772,035	100.0%
Mjete	Numër						
Dalje	"	138,874	135,458	138,413	102%	138,413	100.0%
Hyrje	"	148,048	142,101	146,955	103%	146,955	100.0%
TOTALI	"	286,922	277,559	285,368	103%	285,368	100.0%
Terminali Auto	Numër						
Ditë parkimi	"	15,785	16,903	10,238	61%	9,726	95.0%
Konteinerë të përpunuar	"	5,641	6,346	5,422	85%	5,151	95.0%

Tabela 6: Vëllimet përmblhedhëse në ton

Vëllimet	Vëllimet 2023	Vëllimet Plan 2024	Vëllimet e pritshme 2024	Vëllimet Plan 2025
Terminali I Mallrave Gjenerale	252,518	310,845	268,202	285,900
Terminali I Trageteve	997,488	997,470	1,033,898	1,033,898
Terminali I Mallrave Rifuxho	253,883	200,713	280,934	292,171
Terminali I Konteinerëve	2,068,564	2,224,068	2,038,213	2,038,213
Totali	3,569,470	3,739,987	3,578,535	3,631,230


Grafiku 2: Vëllimet përmblhedhëse

Vëllimet përmblhedhëse (ton)



Në parashikimet e volumeve të mësipërme me gjithë metodologjinë e shpjeguar më lart, është mbajtur në konsideratë ecuria e volumeve të punës në 2 vitet e fundit dhe faktorët të tjerë që parashikohet të ndikojnë tek volumet e punës të tilla si: konkurrenca, situata ekonomike e vendit tonë dhe vendeve me të cilët kemi marrëdhënie tregtare, pritshmeritë që kanë operatorët që operojnë drejtpërdrejt në vend etj. Për vitin 2025 pesha specifike në totalin e volumeve të përpunuar sipas të katër терминаlet pritet të jetë e ndarë në 56% Terminali i Konteinerëve (2024 58%), 28 % Terminali i Trageteve (2024 27%), 8% Terminali i Mallrave Gjenerale (2024 9%) dhe 8% Terminali i Mallrave Rifuxho (2024 6%).

Grafiku 3: Volumet e pritshme 2024 për çdo terminal



2.2 Të Ardhurat


Të ardhurat në APD gjenerohen kryesisht nga operacionet e lëvizjes së mallrave dhe pasagjerëve në pesë терминаlet. Kjo e ardhur përbën 95% të të ardhurës totale, ndërsa pjesa e mbetur prej 5% e të ardhurave gjenerohet nga shërbimet jashtë terminaleve (të ardhura nga leje hyrjet, shërbim mbrojtje nga zjarri, certifikata deratizimi dhe mjekësore anijesh, interesa depozitash, kamata etj.). Në të dhënat e pasqyruara në vijim është hequr ndikimi i luhajteve të kurseve të këmbimit. Terminali i Konteinerëve është kontribuesi më i madh në të ardhurat e APD-së duke gjeneruar rreth 63% të tyre. Kontribuesi i dytë më i madh me rreth 18% të të ardhurave është Terminali i Trageteve. Terminali i Mallrave Gjenerale dhe i Mallrave Rifuxho kontribuojnë respektivisht me 4% dhe 6% në të ardhurat totale të APD ndërsa Terminali i Autove me 3%. Përveç vëllimeve dhe efikasitetit në kryerjen e operacioneve, elementi tjetër që ndikon të ardhurat janë tarifat portuale. Parashikimet në vijimësi janë bazuar në tarifatat aktuale portuale në fuqi, pa llogaritur efektin pozitiv që mund të ketë shtesa e ndonjë tarife për shërbime të reja apo rishikim me rritje të tarifave bazuar qoftë edhe në normën e inflacionit.

Tabela 7: Të ardhurat e përgjithshme

TE ARDHURAT	Fakti 2023	Plani 2024	I pritshmi 2024	Plani 2025
Terminali i Trageteve	588,120,133	615,257,942	559,517,911	559,517,911
Terminali i Konteinerëve	1,786,069,523	1,965,803,840	1,917,522,835	1,917,522,835
Terminali i Mallrave Gjenerale	104,982,349	132,422,396	125,052,858	132,740,430
Terminali i Mallrave Rifuxho	171,643,724	142,356,383	166,503,002	172,907,200
Terminali Auto	114,171,577	119,486,876	96,315,711	91,499,926
Jashtë terminaleve	159,431,777	183,626,404	159,467,779	161,013,978
TOTALI APD	2,924,419,083	3,158,953,842	3,024,380,095	3,035,202,279

Grafiku 4: Të ardhurat 2025 sipas qëndrave të gjenerimit të të ardhurave

Pesha e qëndrave të gjenerimit të të ardhurave



2.2.1 Të ardhurat nga Terminali i Trageteve

Me rritjen e konkurrencës në transportin e pasagjerëve si rezultat i shtimit të linjave ajrore loë cost, gjatë vitit 2024 është ndjerë efekti i një pjese të udhëtarëve që për arsye kostoje, zgjedhën të udhëtojnë me avion duke mos arritur pritshmëritë që kishim. Për këtë arsye kemi bërë një parashikim konservator përse i përket vëllimeve të hyrje daljeve, dhe si rrjedhojë parashikimit të të ardhurave që presim të marrim në Terminalin e Trageteve. Për vitin 2024, parashikojmë që të ardhurat të jenë të njëjta krahasuar me të pritshmin e vitit 2024.

Tabela 8: Të ardhurat sipas zërave TT

Terminali I Trageteve						
Nr	Pershkrimi I të ardhurës	Fakti 2023	Plani Vjetor 2024	I pritshmi 2024	Plani 2025	Plan 2025/I Pritshmi 2024
1	Te ardhurat nga kanali	221,048,071	232,608,332	209,630,269	209,630,269	100%
2	Te ardhurat nga kalata	7,189,530	6,376,274	6,320,969	6,320,969	100%
3	Tarifa te perpunimit te pasagjereve	95,258,856	103,411,903	88,824,258	88,824,258	100%
4	Te ardhura nga perpunimi auto	81,148,295	83,723,939	80,202,206	80,202,206	100%
5	Tarife per sherbime te vecanta	6,226,688	5,828,580	7,342,635	7,342,635	100%
6	Sherbimi i drejtimit te mjetit	3,115,052	3,133,609	2,801,114	2,801,114	100%
7	Te ardhura - qera te shesheve	53,812,427	54,288,648	51,315,971	51,315,971	100%
8	Te ardhura-Qera ambjente tjera	3,414,526	3,404,586	3,249,605	3,249,605	100%
9	Te ardhura - qera mjetet	2,180,670	2,261,291	1,911,999	1,911,999	100%
10	Te ardhurat e Parking-ut	15,115,032	15,197,200	14,981,358	14,981,358	100%
11	Te ardhura per sigurine portuale	81,152,094	84,544,208	76,560,017	76,560,017	100%
12	Te ardhura per energjine elektrike	17,051,608	19,280,362	15,794,548	15,794,548	100%
13	Te ardhura shitje tjera	-	1,500	-	-	-
14	Te ardhura nga Uji	966,980	911,627	582,963	582,963	100%
15	Te ardhura te tjera financiare	440,305	285,884	-	-	-
		588,120,133	615,257,942	559,517,911	559,517,911	100%

2.2.2 Të ardhurat nga Terminali i Konteinerëve

Terminali i konteinerëve aktualisht është afër kapacitetit teorik të përpunimit. Vëllimet e përpunimit për këtë terminal janë parashikuar në të njëjtat nivele me të pritshmin e vitit 2024, për këtë arsye edhe të ardhurat parashikohen të kenë të njëjtin rezultat.

Tabela 9: Të ardhurat sipas zërave TK

Terminali I Konteniereve						
Nr	Pershkrimi I të ardhurës	Fakti 2023	Plani Vjetor 2024	I pritshmi 2024	Plani 2025	Plan 2025/I Pritshmi 2024
1	Te ardhurat nga kanali	61,515,735	66,858,205	61,764,054	61,764,054	100%
2	Te ardhurat nga kalata	21,011,813	22,833,699	15,895,618	15,895,618	100%
3	Te ardhura nga perpunimi kont	1,336,316,228	1,492,980,130	1,418,571,039	1,418,571,039	100%
4	Te ardhurat nga magaz. kont.	243,447,234	249,582,462	276,487,428	276,487,428	100%
6	Te ardhura- Leje hyrje ne port	30,867,604	32,622,334	32,815,735	32,815,735	100%
7	Te ardhura per sigurine portua	45,636,216	48,396,048	50,655,456	50,655,456	100%
8	Te ardhura per energjine eletr	47,046,633	52,242,128	61,302,280	61,302,280	100%
10	Te ardhura shitje tjera	206,026	261,600	-	-	-
12	Te ardhura te tjera financiare	22,035	27,235	31,226	31,226	100%
		1,786,069,523	1,965,803,840	1,917,522,835	1,917,522,835	100%

2.2.3 Të ardhurat nga Terminali i Mallrave Rifuxho

Në Terminalin e Mallrave Rifuxho në 6 mujorin e dytë të vitit 2024 u pa një rritje në vëllimet e përpunimit. Kjo rritje bëri që të rishikojmë pritshmëritë e vëllimeve për vitin 2025 duke marrë parasysh edhe faktorë të tjerë të përmendur më lart. Për rrjedhojë edhe të ardhurat e gjeneruara nga ky terminal priten të rriten në të njëjtën masë, me 4%.

Tabela 8: Të ardhurat sipas zërave TL

Terminali I Mallrave Rifuxho						
Nr	Pershkrimi I të ardhurës	Fakti 2023	Plani Vjetor 2024	I pritshmi 2024	Plani 2025	Plan 2025/I Pritshmi 2024
1	Te ardhurat nga kanali	6,578,665	5,854,714	5,355,909	5,570,146	104%
2	Te ardhurat nga kalata	6,672,147	5,497,845	9,229,143	9,598,308	104%
3	Tarifat për përpunimin e mallrave	14,000,638	12,401,263	11,167,022	11,613,703	104%
4	Te ardhura nga perpunimi I mineraleve në konteinerë	13,859,706	10,724,683	12,173,449	12,660,387	104%
5	Te ardhurat wharfage	680,958	589,672	795,560	827,382	104%
6	Te ardhurat magazinazhi I kont.	1,740,519	1,234,726	1,016,973	1,057,652	104%
7	Te ardhurat nga magazinazhi I ngark.	716,954	596,531	548,275	570,206	104%
8	Te ardhura nga qeratë e shesheve	113,425,865	93,737,876	114,066,440	118,629,098	104%
10	Te ardhurat nga Parkingu	102,049	76,402	75,664	78,690	104%
11	Te ardhura nga leje hyrjet ne port	282,931	246,092	334,860	348,254	104%
12	Te ardhura per sigurine portuale	3,800,730	3,293,308	4,843,333	5,037,066	104%
13	Te ardhura per energjine elektrike	9,171,507	7,595,664	6,398,045	6,398,045	100%
15	Te ardhura nga shitje tjera	69,000	66,240	-	-	-
16	Te ardhura nga furnizimi me ujë	465,880	368,265	498,329	518,262	104%
17	Te ardhura te tjera financiare	76,174	73,101	-	-	-
		171,643,724	142,356,383	166,503,002	172,907,200	104%

2.2.4 Të ardhurat nga Terminali i Mallrave Gjenerale

Në Terminalin e Mallrave Gjenerale, mosrealizimi i planit 2024 bëri që të rishikohet norma e pritshme e rritjes, duke gjykuar që arritjen e vëllimeve të parashikuara për këtë vit ta realizojmë në vitin 2025. Në këtë kontekst, parashikohet një rritje më 6% edhe në të ardhurat që do gjenerohen nga ky terminal.

Tabela 9: Të ardhurat sipas zërave TMGJ

TERMINALI I MALLRAVE GJENERALE						
Nr	Pershkrimi I të ardhurës	Fakti 2023	Plani Vjetor 2024	I pritshmi 2024	Plani 2025	Plan 2025/I Pritshmi 2024
1	Te ardhurat nga kanali	6,401,899	7,795,529	6,779,352	7,253,907	107%
2	Te ardhurat nga kalata	15,867,392	19,602,682	17,914,960	19,169,007	107%
3	Tarifat për perpunimin e mallrave	65,634,430	85,126,841	78,258,408	83,736,497	107%
4	Te ardhura nga perpunimi	128,427	238,702	233,421	249,760	107%
5	Te ardhurat nga sherbimi wharfage	6,139,640	7,452,155	6,636,319	7,100,861	107%
6	Te ardhura - qera sheshe tranzitore	-	1,613,722	-	-	-
7	Te ardhura nga silosat	243,840	58,522	168,471	168,471	100%
8	Te ardhura-Qera afatgj sheshet	266,400	420,123	286,585	286,585	100%
9	Te ardhura-Qera ambiente tjera	165,647	183,826	207,311	207,311	100%
10	Te ardhura - qera mjetet	77,123	84,105	104,783	104,783	100%
11	Te ardhura- Leje hyrje ne port	2,565,654	3,109,984	2,782,587	2,782,587	100%
12	Te ardhura per sigurine portuale	4,108,232	5,012,176	4,415,740	4,415,740	100%
13	Te ardhura per energjine elektrike	1,787,758	1,606,207	3,307,388	3,307,388	100%
14	Te ardhura shitje tjera	1,498,200	52,167	3,941,036	3,941,036	100%
15	Te ardhura te tjera financiare	97,706	65,655	16,496	16,496	100%
		104,982,349	132,422,396	125,052,858	132,740,430	106%

2.2.5 Të ardhurat nga Terminali Auto

Nisur nga rënia e vëllimeve të përpunimit në Terminalin Auto si rezultat I konkurrencës së shtuar nga linja Ro-Ro që importon automjetet dhe përpunohet në portin privat në Porto Romano, edhe të ardhurat e pritshme që do gjenerohen nga ky terminal priten të ndjekin të njëjtin tren në rënie.

Terminali I Autove						
Nr	Pershkrimi I të ardhurës	Fakti 2023	Plani Vjetor 2024	I pritshmi 2024	Plani 2025	Plan 2025/I Pritshmi 2024
1	Te ardhurat nga parkimi I mjeteve	8,020,812	8,586,624	5,229,814	4,968,323	95%
2	Te ardhurat nga perpunimi i autove në konteinere	106,150,765	110,900,252	91,085,897	86,531,603	95%
		114,171,577	119,486,876	96,315,711	91,499,926	95%

2.2.6 Të ardhurat jashtë zonave të terminaleve

Në këtë kategori përfshihen të ardhura të cilat nuk gjenerohen nga operacionet në terminale por nga shërbime plotësuese të tjera të cilët tarifohen sipas tarifave përkatëse të përcaktuara në librin e tarifave të APD-së si dhe të ardhura të tjera me karakter financiar. Këto të ardhura nuk janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me luhatjet e vëllimeve të përpunimit dhe edhe për vitin 2025 parashikohet të jenë përafërsisht sa të ardhurat e pritshme të vitit 2024. E vetmja shtesë parashikohet të vije nga të ardhurat e pritshme për tu realizuar nga qendra e ekselences detare (CEMA) si rezultat i kurseve profesionale që kjo qendër ofron. Ndërkohë efekti i fitimit (apo dhe humbjes) nga ndryshimet e kursit të këmbimit Eur/Lek janë të paparashikueshme, prandaj për këtë zë nuk kemi bërë planifikim dhe për të bërë krahasim të drejtë mes periudhave kemi hequr efektin faktik për vitin 2023 dhe 2024.

Tabela 10: Të ardhurat sipa zërave JT

Zonat jashtë Terminaleve						
Nr	Pershkrimi I të ardhurës	Fakti 2023	Plani Vjetor 2024	I pritshmi 2024	Plani 2025	Plan 2025/I Pritshmi 2024
6	Te ardhura certif.deratizimit	414,340	582,894	583,287	583,287	100%
7	Te ardhura certif.mjek.anije	630,292	921,440	904,354	904,354	100%
8	Te ardhura mbroj.zjarr&shpetim	7,809,950	10,750,494	8,731,058	8,731,058	100%
10	Te ardhura- Leje hyrje ne port	36,561,250	50,675,991	36,537,305	36,537,305	100%
11	Te ardhura per energjine eletr	25,748,241	34,020,174	37,372,025	37,372,025	100%
12	Te ardhura shitje tjera	19,022,118	30,299,148	11,545,572	11,545,572	100%
13	Te ardhura nga kurse të ndryshme	331,000	533,172	-	1,440,000	
14	Te ardhura nga Uji	4,855,520	6,470,238	6,193,242	6,193,242	100%
15	Te ardhura nga njohja e granteve	60,248,052	44,393,054	44,393,054	44,500,000	100%
16	Penalite dhe gjoba te arketu	1,043,923	1,584,893	1,034,917	1,034,917	100%
17	Te ndryshme	36,808	152,697	10,881,365	10,881,365	100%
18	Te ardhura nga interesat	39,313	60,842	5,747	5,000	87%
19	Interesa per depozitat	1,745,721	2,094,865	-	-	
20	Te ardhura te tjera financiare	945,251	1,086,503	1,285,853	1,285,853	100%
		159,431,778	183,626,404	159,467,779	161,013,978	101%

2.3 Shpenzimet

Shpenzimet e APD-së kanë natyrë kryesisht operacionale, pra shkojnë për mbështetjen e aktivitetit dhe garantimin e vijueshmërinë e tij në funksion të gjenerimit të të ardhurave. Këtu grupohen pjesa më e madhe e shpenzimeve që ka APD, duke përfshirë blerjet e materialeve dhe artikujve të konsumit për mirëmbajtje dhe përdorim gjatë aktivitetit të përditshëm, pagesat e operatorëve të cilët bëjnë mirëmbajtjen e aseteve të APD-së, pagat e punonjësve, shpenzimet utilitare për energji dhe ujë, kosto trajnimi, licensimi etj.

Pjesa tjetër e shpenzimeve kanë një natyrë financiare dhe lidhen kryesisht me kostot e financimit të shoqërisë, kostot e amortizimit të aktiveve, detyrimet ndaj pronarit dhe kosto të tjera financiare si shpenzimet për interes e huave, tarifata bankare, pagesa dividendi dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Sidoqoftë, për vetë luhatshmërinë që ka dhe pamundësinë e parashikimit dhe për të garantuar një krahasim të drejtë mes periudhave dhe parashikimit, humbjet nga kurset e këmbimit është hequr nga pasqyrat në vijim.

Viti 2025 nis me ndryshime të rëndësishme si rezultat I përfundimit në janar të kontratës së shërbimit të operimit në Terminalin e Kontenerëve. Ky ndryshim na detyron të rrisim shpenzimet operative dhe të shtojmë strukturën operuese për këtë terminal brenda strukturës aktuale të APD, duke sjellë si rezultat edhe një rritje të konsiderueshme të fondit të pagave dhe shpenzimeve të tjera që kanë lidhje kryesisht me punonjësit, si dhe shpenzimeve operative për mirëmbajtje, karburant dhe sisteme të operimit të këtij terminali.

Megjithatë, pavarësisht efektit të arsyes shpjeguar më sipër mbi totalin e shpenzimeve, jemi treguar të kujdesshëm dhe konservatorë në parashikimin për zërat e tjerë të shpenzimeve, që edhe pas efektit që mund të ketë sjellë rritja e cmimeve në përgjithësi (shërbime mirëmbajtje, materiale, utilitete) shpenzimet e parashikuara për vitin 2025 janë planifikuar të jenë 7% më të ulta se fakti 2024 dhe 8% më të ulta se plani i vitit 2024.

Tabela 11: Shpenzimet totale

SHPENZIME	Fakti 2023	Plani 2024	I pritshmi 2024	Plani 2025	Plan 2025/Plan 2024
Furnizime e shërbime	1,294,526,188	1,315,565,897	1,265,667,068	811,925,245	62%
Shpenzime të tjera operative	125,918,641	274,168,726	348,522,900	280,012,983	102%
Pagat e personelit	496,023,431	552,000,000	547,070,349	711,000,000	129%
Sigurime shoqërore	82,551,878	91,687,000	90,546,484	118,737,000	130%
Shpërblime, honorare dhe shpenzime të tjera sipas politikave për trajtimin e punonjësve	45,375,386	56,860,880	50,110,880	71,250,000	125%
Fond Pensioni	36,737,863	46,750,000	40,699,082	59,250,000	127%
Taksa lokale	115,450	7,877,096	7,877,096	7,935,000	101%
Shpenzime Provizionit	94,662,270	10,000,000	10,000,000	43,978,162	440%
Amortizimi	592,681,709	572,017,220	532,811,959	592,988,834	104%
Shpenzime interesi për huatë	9,033,854	6,911,064	6,301,736	6,500,000	94%
TOTALI	2,777,626,670	2,933,837,883	2,899,607,554	2,703,577,225	92%

2.3.1 Shpenzimet për furnizime e shërbime

Shpenzimet për furnizime e shërbime përfaqësojnë kryesisht blerje me procedura prokurimi si pjesët e këmbimi, karburant, veshmbathje, kancelari dhe shpenzime për furnizim me energji dhe ujë. Në këtë kategori hyjnë edhe shpenzimet e mirëmbajtjes që përbëhen nga vlera e kontratave të lidhura ndërmjet APD-së dhe operatorëve privat me afat disa vjeçarë. Të tilla janë:

- Shërbimi i operimit në Terminalin e Kontenerëve; (në përfundim në janar 2025)
- Shërbimi i mirëmbajtjes TIK për 3 vite;
- Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të sigurisë për 3 vite;
- Shërbimi i mirëmbajtjes së Aseteve Energjitike për 3 vite ;
- Shërbime - ISO (Auditime, trajnime + ricertifikim) për 3 vite;
- Shërbimi i mirëmbajtjes së Rrjeti Hidrik;
- Shërbimi i Printimit për 3 vite;
- Auditimi i pasqyrave Financiare për 3 vite;
- Pastrimi i akuatoriumit për 3 vite;
- Pastrimi i ambjenteve të jashtme të APD-së, për 3 vite;

Tabela 12: Detajimi i shpenzimeve për furnizime e shërbime

FURNIZIME E SHËRBIME	Fakti 2023	Plani 2024 I ndryshuar	I pritshmi 2024	Plani 2025
Shpenzime TVSH e karburantit	2,522,730	3,584,907	1,678,953	32,276,876
Materiale të para depo	57,605,547	68,999,913	51,441,971	311,317,097
Blerje energji	130,572,229	132,000,000	131,947,871	132,000,000
Blerje uje	34,640,310	30,125,962	44,804,389	43,000,000
Blerje /shpenzime mallra,shërb	12,871,422	31,867,220	9,406,132	31,393,000
Mirembajtje dhe riparime	34,294,630	12,000,000	9,188,384	55,053,933
Mirmb & rip. Tetra Solutions	27,443,265	28,671,210	28,671,210	36,090,701
Mirmb & riparime Mirembajtje rrjeti hidrik	13,487,500	12,450,000	12,450,000	13,356,667
Mirembajt Riparime Infosoft	1,429,608	4,625,000	4,625,000	4,625,000
Pastrimi	15,453,191	17,450,793	17,450,793	17,450,793
Pastrim, akuarium	9,216,900	7,719,750	7,719,750	7,719,750
Mirembajt riparime MIE	24,059,612	28,449,600	28,449,600	28,449,600
Mirembajtje gjelberim	1,242,700	2,000,000	960,000	3,955,217
Mirembajte, riparime AES	9,738,716	10,742,112	10,742,112	13,706,644
Shërbim Menaxhimi T.K	906,589,117	899,959,631	899,959,631	58,584,764
Auditi nderkomb. dhe ekspertet	3,300,000	3,300,000	3,400,290	3,300,000
Komision për axhensitë	9,675,651	15,000,000	2,270,981	10,000,000
Shpenzime ndryshme per projekt	383,060	6,619,800	500,000	9,645,204
TOTALI	1,294,526,188	1,315,565,897	1,265,667,068	811,925,245

2.3.2 Shpenzimet të tjera operative

Shpenzime të tjera operative janë shpenzime të tjera në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit të cilat detajohen si vijon:

Tabela 13: Shpenzimet e tjera operative

SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE	Fakti 2023	Plani 2024 I ndryshuar	I pritshmi 2024	Plani 2025
Sigurime	19,119,910	19,745,816	19,745,816	25,200,000
1% te perndjekurit politike	4,960,234	5,610,000	5,610,000	5,550,000
Te ndryshme	40,917,780	183,220,100	250,412,360	108,664,703
Publicitet dhe reklama	939,034	2,500,000	187,556	3,000,000
Transferime, udhetim, dieta	3,218,916	2,500,000	2,500,000	2,500,000
Shpenzime postare e telekom	2,225,016	1,900,000	3,703,133	1,500,000
Sherbime bankare	1,024,250	1,000,000	1,039,010	1,200,000
Trajnimet	22,991,402	33,141,500	39,703,274	27,133,420
Shpenzime pritje & perfaqesime	2,273,953	4,551,310	3,009,608	5,110,000
Gjoha dhe demshperblime	11,255,843	-	2,182	-
Qera	16,992,304	20,000,000	22,609,961	100,154,860
TOTAL	125,918,641	274,168,726	348,522,900	280,012,983

2.3.3 Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore:

Shpenzimet për personelin përbëhen nga shpenzimet për paga, shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetsore si dhe ndihma ekonomike në rast sëmundje apo fatkeqësie. Shtimi I struktues

operuese për terminalin e konteinereve brenda strukture aktuale të APD, ka sjellë një efekt në rritje të këtyre shpenzimeve në masën 28%.

Tabela 14: Shpenzime për paga, honorare

SHPENZIME PER PUNONJESIT DHE HONORARE	Fakti 2023	Plani 2024	I pritshmi 2024	Plani 2025	Plan 2025/Plan 2024
Pagat e personelit	496,023,431	552,000,000	547,070,349	711,000,000	129%
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	82,551,878	91,687,000	90,546,484	118,737,000	130%
Shpenzime te tjera per personelin (shperblim dhe ndihma)	40,778,477	50,750,000	44,000,000	65,250,000	129%
Honorare	4,596,909	6,110,880	6,110,880	6,000,000	98%
Fond pensioni per punonjesit	36,737,863	46,750,000	40,699,082	59,250,000	127%
TOTALI	660,688,558	747,297,880	728,426,795	960,237,000	128%

2.3.4 Shpenzime për ripagim të huave, amortizimin dhe provizione të ndryshme

- 3.3 Sasitë e parashikuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parashikuara.
- 3.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuar dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.
- 3.5 Nëse operatori ekonomik, palë në këtë marrëveshjen kuadër, nuk arrin të përmbushë me kriteret e kualifikimit, për të cilat është shpallur fitues, është i detyruar të njoftojë autoritetin kontraktor menjëherë, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i ndodhjes në një situatë të tillë.

Neni 4: Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

- 4.1 Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje kuadër do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit.

Neni 5: Çmimet dhe Vlera

- 5.1 Çmimet për njësi të mallrave përkatëse janë treguar në Formularin e Ofertës Ekonomike.
- 5.2 Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë kësaj marrëveshje kuadër, sipas objektit dhe çmimit të përcaktuar në Formularin e Ofertës Ekonomike, të paraqitur nga Ofertuesi, janë si vijon:
 - **Vlera pa TVSH** = 19.940.000 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet mijë) lekë pa tvsh.
 - **Vlera me TVSH** = 23.928.000 (njëzet e tre milion e nëntëqind e njëzet e tetë mijë) lekë, me tvsh.
- 5.3 Çmimet e njësisë duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.

ALBANIAN STEVEDORING COMPANY SHPK
Lagjia Nr. 1 Rrg. tregtare
Porti Durrës, Albania



AUTORITETI PORTUAL DURRËS

"ALBANIAN STEVEDORING COMPANY" (ASC)

Neni 6: Komunikimi ndërmjet Palëve

- 6.1 Komunikimi ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit, palë të kësaj marrëveshje kuadër, do të bëhet në formë të shkresore ose elektronike (e-mail, fax etj) dhe, në çdo rast, duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës. Forma e komunikimit përzgjidhet nga Autoriteti Kontraktor, në varësi të kohës në dispozicion për përmbushjen e nevojës. Në çdo rast, me iniciativë të Drejtorisë porositore, Autoriteti Kontraktor duhet t'i dërgojë Kontraktorit ftesën për ofertë, për sasi të artikujve që nevojiten.

Neni 7: Përfaqësimi i Palëve

- 7.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e marrëveshjes, si dhe të çdo kontrate më vete.
- 7.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 7.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 8: Dispozita të Fundit

- 8.1 Kjo Marrëveshje Kuadër pranohet me të gjithë përcaktimet e saj dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.
- 8.2 Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje ekemplare me përmbajtje të njëjtë: 3 (tre) për Autoritetin Kontraktor dhe 1 (një) për Kontraktuesin.

PALET KONTRAKTORE

Për Autoritetin Kontraktor:

AUTORITETI PORTUAL DURRËS

Z. Pirro Xenu

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Për Kontraktuesin:

ALBANIAN STEVEDORING COMPANY (ASC)
SHPK

LORIK Hoxha

Administratori
ALBANIAN STEVEDORING COMPANY SHPK
Lagjja Nr. 1 Rrg. tregtare
Porti Durrës, Albania

Divizioni FORCA E SIGURISE PORTUALE DURRES

(FSPD)

Objekti: *Blerje Radio komunikimi me FSPD/Kapitenerine/Anijet etj, per OSP dhe OSZP.*

Fondi i parashikuar: *Shiko ofertat bashkengjitur*

Qëllimi dhe Argumentimi:

Me qëllim komunikimi sa më të shpejtë në kohë reale si në situatë normale, rast emergjence apo incidente sigurie me FSPD, Kapitenerine e Portit, anjet etj lind nevoja e pajisjes së Oficerit të Sigurisë së Portit dhe 4 Oficerëve të Sigurisë së Zonave Portuale.

E nevojshme 3 mujori I 2025



Adresa: Rruga "Islam Alla" Pall.56/1, Tiranë
NIPT: L22203042N
Telefon Mobile. +355 69 20 45590
E-mail. info@atom.al, a.agolli@atom.al
Faqja e Internetit. www.atom.al

Tiranë, më __/__/2024

FORMULARI I OFERTËS

Drejtuar: **Autoriteti Portual Durrës**

Nr.	Pershkrimi i Produkteve/Shërbimeve	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi	ÇmimiTotal
1	Radio (Full Keypad)	copë	5	78,900	394,500
				Vlera pa TVSH	394,500
				TVSH	78,900
				Vlera me TVSH	473,400

- *Cmimet janë të shprehura në monedhën lekë.*

Administrator
Luan Basha





Adresa: Rruga "Islam Alla" Pall.56/1, Tiranë
NIPT: L22203042N
Telefon Mobile. +355 69 20 45590
E-mail. info@atom.al, a.agolli@atom.al
Faqja e Internetit. www.atom.al

Specifikimet e Produktit

Specifikimet e Përgjithshme:

- Frekvenca e Funksionimit:
- VHF: 136-174 MHz
- UHF: 400-470 MHz / 450-520 MHz
- Modelet e Komunikimit:
- NXDN Digjital dhe Analog FM
- DMR Tier II, që lejon lidhjen e radios në sisteme DMR për komunikim të sigurt.
- Mixed Mode Operation, që mund të kalojë automatikisht mes modave digjitale dhe analoge bazuar në sinjalin që pranohet.
- Fuqia e Daljes: 5 W (High) / 1 W (Low)
- Numri i Kanaleve: 260 kanale të programueshme
- Banda e Kanalit:
- NXDN digjital: 6.25 kHz
- Analog: 12.5 kHz dhe 25 kHz (në varësi të rregullave lokale)
- Ekran LCD me ngjyra dhe Tastierë e plotë alfanumerike për lehtësi në përdorim.

Karakteristika të Sigurisë:

- Encryption: AES 256-bit encryption për siguri të avancuar në komunikime.
- Emergjenca: Funksion SOS, butoni i emergjencës për situata kritike.
- Man Down Function: Aktivizohet në rast rëniesje të radios.

Ndërfaqet dhe Funksionet e Avancuara:

- Bluetooth v4.0 për lidhje të pajisjeve të jashtme (si kufje).
- GPS i integruar për gjurmim të radios në terren.
- IP54/55/67: Rezistente ndaj pluhurit dhe ujit, e përshtatshme për kushte të vështira të ambientit.
- MIL-STD 810 C/D/E/F/G: Plotëson standardet ushtarake për rezistencë ndaj dridhjeve, goditjeve dhe temperaturave ekstreme.

Bateria:

- Koha e funksionimit të baterisë: Deri në 15 orë në modalitetin digjital me bateri Li-Ion standarde (7.5V/2000mAh).

Administrator
Luan Basha





Tiranë, më __/__/2024

OFERTË

Emri i ofertuesit: **Microtech**

Për: **Autoriteti Portual Durres**

NR	Emertimi	Sasia	Cmimi Pa TVSH	Totali Pa TVSH
1	Radio (Full Keypad)	5	77400	387000
Totali pa TVSh				387000

Specifikimet e Përgjithshme:

- Frekvenca e Funksionimit:
- VHF: 136-174 MHz
- UHF: 400-470 MHz / 450-520 MHz
- Modelet e Komunikimit:
- NXDN Digjital dhe Analog FM
- DMR Tier II, që lejon lidhjen e radios në sisteme DMR për komunikim të sigurt.
- Mixed Mode Operation, që mund të kalojë automatikisht mes modave digjitale dhe analoge bazuar në sinjalin që pranohet.
- Fuqia e Daljes: 5 W (High) / 1 W (Low)
- Numri i Kanaleve: 260 kanale të programueshme
- Banda e Kanalit:
- NXDN digjital: 6.25 kHz
- Analog: 12.5 kHz dhe 25 kHz (në varësi të rregullave lokale)
- Ekran LCD me ngjyra dhe Tastierë e plotë alfanumerike për lehtësi në përdorim.

Karakteristika të Sigurisë:

- Encryption: AES 256-bit encryption për siguri të avancuar në komunikime.
- Emergenca: Funksion SOS, butoni i emergjencës për situata kritike.
- Man Down Function: Aktivizohet në rast rënies së radios.



Adresa: Rruga Mujo Ulqinaku, Pallati Teknoprojekt, Kati 1, Ap. 5, Tiranë

Website: www.microtech.al

E-Mail: info@microtech.al

Telefon: (+355) 69 408 6232

Microtech[®] COMPUTER SYSTEMS

Ndërfaqet dhe Funksonet e Avancuara:

- Bluetooth v4.0 për lidhje të pajisjeve të jashtme (si kufje).
- GPS i integruar për gjurmim të radios në terren.
- IP54/55/67: Rezistente ndaj pluhurit dhe ujit, e përshtatshme për kushte të vështira të ambientit.
- MIL-STD 810 C/D/E/F/G: Plotëson standardet ushtarake për rezistencë ndaj dridhjeve, goditjeve dhe temperaturave ekstreme.

Bateria:

Koha e funksionimit të baterisë: Deri në 15 orë në modalitetin digjital me bateri Li-Ion standarde (7.5V/2000mAh).

Administrator

Rixhi Koçi





SHPENZIME PER POLUMBARET

SHPENZIME MATERIALE 2025 PAJISJE PROFESONALE									
Nr.	EMERTIMI	Njësia	Nevojat për materjale	Gjëndja magazin	Çmimi 1 çmimi magazinës	Çmimi 2 hetim Tregu	Çmimi 3 hetim Tregu	Çmimi përfundimtar mesatar	VLERA
1	Kostum zhytje neopreni 7m/m	Cope	2			45.000			90.000
2	Kostum zhytje neopreni 5m/m	Cope	2			40.000			80.000
3	Kostum zhytje neopreni 3m/m	Cope	2			30.000			60.000
4	Grinder me bateri per prerje dhe pastrim nen uhor	Cope	1			480.000			480.000
5	Bombula zhytje	Cope	2			50.000			100.000
6	Xhakete zhytje	Cope	2			45.000			90.000
7	Manometra presioni	Cope	4			15.000			60.000
11									
Totali									960.000



“seI3^**“ **et

Lagja nr. 17, Rruga “Dahy Peza” Durrës
NIPT K72301501E

TeL 068 2223762, e-mail igrashi@bluadriatico.roin
Kapitali i shoqerise z.000.000 leke

SPECIFIKIMET E PAJISJEVE TE POLUMBAREVE

Kostum zhytje: Model FISTERRA i perbere nga neopreni spesori 7 mm, pa zinxhir.
Cope 2, masat XL dhe XXL. Cmimi: 45 000 Leke copa.

Kostum zhytje: Model FISTERRA i perbere nga neopreni spesori 5 mm, pa zinxhir.
Cope 2, masat XL dhe XXL. Cmimi: 40 000 Leke copa.

Kostum zhytje: Model FISTERRA i perbere nga neopreni spesori 3 mm, pa zinxhir.
Cope 2, masat XL dhe XXL. Cmimi: 30 000 Leke copa.

Grinder me bateri per prerje dhe pastrim nen ujqor model : Nemo V2 i pajisur me
Cope 2 bateri 22V 6Ah + Cope 1 karikues Cmimi: 480 000 Leke

Bombola zhytje: Model 10 litra, e perbere nga celiku, rubineti me dy dalje, rijeta mbrojtese dhe
baza mbajtese prej plastike.
Cope 2. Cmimi: 50 000 Leke copa.

Xhakete zhytje: Model X-Force e perbere nga materiali resistent ndaj ferkimeve, me valvulat
perkatese dhe rripat per montimin e bomboles.
Cope 2, Masat L dhe XL. Cmimi: 45 000 Leke copa.

Manometra presioni: Model Mision 1 deri ne 300 Bar te pajisur me tubin perkates dhe kellefin
mbrojtjes prej plastike.
Cope 4 Cmimi: 15 000 leke copa.

ADMINISTRATORI
ELTON GRASHI



SHPENZIME MATERIALE SPECIFIKE PER NJESINE E LEJEVE

SHPENZIME MATERIALE FSPD 2025								
Nr	EMERTIMI	Njësia	Nevoja t për materjale	Çmimi 1 hetim tregu LUMACOM	Çmimi 2 hetim Tregu ATOM shpk	Çmimi 3 hetim Tregu MICRO TEH	Çmimi përfundim tar mesatar	VLERA
1	Printer MagicCARD Rio Pro	cope	1	248000	248000	247000	247700	247000
3	Karta Elektronike R-FID	cope	4000	435	450	440	442	1768000
4	Printer per barkode	cope	3	68000	70000	70000	69000	207000
5	Kartona per leje ditore	cope	250.000	6,50	7	7,5	7	175000
6	Setet e nevojshme te filmave-Sete Pastrimi	cope	25	15000	15000	15000	15000	375000
7	Rula termik per kasa fiskale	cope	500	52	50	60	54	27000
8	Shirit me ngjyre per printer	Cope	25	19000	18000	19000	18700	467500
							SHUMA	3.266.500

Argumentimi pse duhet ky shpenzim.

Shpenzimet e paraqitura në tabelën përkatëse kanë dalë nga detyrimi për kompletim të njesise se lejeve me materiale specifike për pajisjen e qytetareve me leje elektronike ditore dhe vjetore, në zbatim të regjimit të hyrje daljeve miratuar me nr 965 prot date 23.03.2023 gjendja reale në magazine, dhe nevojat për funksionimin Njesise për një vit.

1 of 1

LUMACOM
broadliner

hp dell CISCO SAMSUNG Canon LEXMARK acer

Konsulence, suport, zgjidhje, distribucion i paisjeve teknologjike, sherbime logjistike

Tiranë, më 2024

FORMULARI I OFERTËS

Ofertuesi :

Lumacom

Per:

Autoriteti Portual Durrës

NR	Pershkrimi	Sasia	Cmimi	Totali
1	Printer MagicCARD Rio Pro	1	248,000	248,000
2	Kompjuter Kompet	3	188,000	564,000
3	Karta Elektronike R-FID	4,000	435	1,740,000
4	Printer per Barkode	3	68,000	204,000
5	Kartona per leje ditore	250,000	6.50	1,625,000
6	Setet e nevojshme te filmave – Sete Pastrimi	25	15,000	375,000
7	Rula termik per kasa fiskale	500	52	26,000
8	Shirit me ngjyre per printer	25	19,000	475,000
Shuma totale pa TVSH				5,257,000

Administrator
Jakup Bulica



LUMACOM shpk - NIP: L61502032M Rr. "Don Bosko" Tirane 10012
www.lumacom.al



1 of 1



Adresa: Rruga "Islam Alla" Pall.56/1, Tiranë
NIPIT: L22030428
Telefon Mobile: +355 69 20 45590
E-mail: info@atom.al, a.agolli@atom.al
Faqja e Internetit: www.atom.al

Datë __/__/2024

FORMULARI I OFERTËS

Emri i ofertuesit:

ATOM shpk

Drejtuar :

Autoriteti Portual Durrës

1	2	3	4	5	6
Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmim Njesi Pa TVSH	Cmim Total Pa TVSH
1	Printer MagicCARD Rio Pro	Copë	1	248,000	248,000
2	Kompjuter Kompet	Copë	3	180,000	540,000
3	Karta Elektronike R-FID	Copë	4,000	450	1,800,000
4	Printer per Barkode	Copë	3	70,000	210,000
5	Kartona per leje ditore	Copë	250,000	7	1,750,000
6	Setet e nevojshme te filmave – Sete Pastrimi	Copë	25	15,000	375,000
7	Rula termik per kasa fiskale	Copë	500	50	25,000
8	Shirit me ngjyre per printer	Copë	25	18,000	450,000
Total Pa TVSH					5,398,000
TVSH					1,079,600
Totali me TVSH					6,477,600

Administrator
Luan Basha





Tiranë, më __/__/2024

OFERTË

Emri i ofertuesit: **Microtech**

Për: **Autoriteti Portual Durrës**

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmim Njesi Pa TVSH	Cmim Total Pa TVSH
1	Printer MagicCARD Rio Pro	Copë	1	247,000	247,000
2	Kompjuter Kompet	Copë	3	191,000	573,000
3	Karta Elektronike R-FID	Copë	4,000	440	1,760,000
4	Printer per Barkode	Copë	3	70,000	210,000
5	Kartona per leje ditore	Copë	250,000	7.5	1,875,000
6	Setet e nevojshme te filmave - Sete Pastrimi	Copë	25	15,000	375,000
7	Rula termik per kasa fiskale	Copë	500	60	30,000
8	Shirit me ngjyre per printer	Copë	25	19,000	475,000
Total Pa TVSH					5,545,000

Administrator

Rixhi Koçi



Adresa: Rruga Myslym Shyri, Godina Nr. 46/1, Njësia Bashkiake Nr. 10, Kati 2.

Website: www.microtech.al

E-Mail: info@microtech.al

Telefon: (+355) 069 5362586



SHPENZIME PER PAJISJE PROFESIONALE

SHPENZIME MATERIALE 2025 PAJISJE PROFESIONALE					
Nr.	EMERTIMI	Njësia	Nevojat për materjale	Çmimi 1 çmimi magazinës	VLERA
1	Pasqyra kontrolli per autovetura	Cope	2	14,700	29,400
2	Pasqyra kontrolli per kamiona	Cope	4	25,000	100,000
3	Kellef pistolete	Cope	60	5,430	325,800
4	Mbajtese kerheri fishekesh	Cope	80	2,455	196,400
5	Shirit plastik rrethimi i (role 100m)	Cope	100	800	80,000
6	Elektrik professional I karikueshem	Cope	5	14,800	74,000
7	Dryna profesionale	Cope	20	6,820	136,400
8	Zinxhir metalik per drynat	ml	20	500	10,000
9	Feneline per skafin "ranieri"	Cope	1	13,000	13,000
10	Bateri dedektori te karikueshme	Cope	10	880	8,800
11	Kone trafiku fluoreshente	Cope	20	2,500	50,000
Totali					1.023.800

Veshmbathje FSPD

		SHPENZIME MATERIALE 2025				VESHMBATHJE
EMERTIMI	Njësia	Nevojat për material e	Gjëndja magazin	Çmimi 1 çmimi magazinës	Çmimi përfundimt ar mesatar	VLERA
VESHJE DIMERORE						
Bluze pambuku me minge te gjata	cope	390	0	3,000	3,000	1,170,000
Kepuce dimerore	pale	130	0	6,500	6,500	845,000
corape burrash	pale	390	0	571	571	222,690
VESHJESH VERORE						
Bluze pambuku me minge te shku	cope	390	0	2,000	2,000	780,000
kepuce verore	pale	130	0	4,500	4,500	585,000
Jelek fosforeshent me xhepa dhe zinxhir	cope	130	0	2,600	2,600	338,000
Shuma						3,940,690

Drejtoria e Ndërgjegjësimit Publik dhe Promovimit të Shërbimit

Nr. 2832 / Prot.

Durrës më 31.12.2024

I BRENSHËM

Objekti: Mbi parashikimin e fondeve të Drejtorisë së Ndërgjegjësimit Publik dhe Promovimit të Shërbimeve Komunikimit për Plan Biznesin për periudhën 2025-2026.


Fondi i parashikuar: 7,700,000 leke

Qëllimi dhe Argumentimi:

Në zbatim të UB. Nr. 412, dt. 7.2.2024, "Mbi hartimin e Plan Biznesit tre vjeçar 2024 – 2025 të Autoritetit Portual Durrës" si dhe bazuar në Rregulloren Organizative të APD-së, Drejtoria e Ndërgjegjësimit Publik dhe Promovimit të Shërbimeve, ka parashikuar shpenzimet për vitin 2025, në raport me logjistikën promocionale, protokollin e marrëdhënieve me jashtë, identitetin vizual dhe komunikimin institucional në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të APD-së.

Në vijim shpjegimi për zërat përkatës të parashikuar:

	<i>Emërtimi</i>	<i>Vlera lekë</i>
1	<i>Shtypshkrime për komunikimin, promovimin dhe pritjet zyrtare</i>	<i>1,400,000</i>
2	<i>Abonime vjetore në gazeta dhe revista kombëtare dhe ndërkombëtare me fokus ekonomiko-social</i>	<i>400,000</i>
3	<i>Aktivitetet e Përvitshme në kuadër të "World Maritime Day 2025"</i>	<i>3,000,000</i>
4	<i>Dekori festiv i fundvitit</i>	<i>100,000</i>
5	<i>Përfaqësimi i shërbimeve të APD-së në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare.</i>	<i>1,000,000</i>
6	<i>Protokolli i pritje-përcjellje (kafe, ujë, drekë)</i>	<i>1,000,000</i>
7	<i>Publikim, stampim, online, digjitale</i>	<i>800,000</i>
Totali	7,700,000	

<p>Autoriteti Portual Durrës DURRES PORT AUTHORITY</p> 	PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT		
	KËRKESË PËR INVESTIM/ SHPENZIM		
Kodi Nr.: P.180-F.01	Versioni: 1	Data Efektive: 24.06.2024	Faqe 2 / 4

Relacion shpjegues

Drejtorja e Ndërgjegjësimit Publik dhe Promovimit të Shërbimeve, në referencë të zhvillimeve të fundit, të cilat kanë të bëjnë jo vetëm me iniciativa dhe projekte të prezantuara në Autoritetin Portual Durrës por edhe investimet, të cilat janë në proces implementimi, parashtron nevojën për këto zëra të parashikuara në Plan Biznesin për vitin 2025:

Duke sjellë në vëmendje se planifikimi i shpenzimeve për vitin 2025 është bazuar në krijimin e një identiteti të mirëfilltë vizual për institucionin, me qëllim një promovim dhe prezantim dinjitoz dhe kuptimplotë të veprimtarisë së Autoritetit Portual, propozojmë vlerat përkatëse për zërat si vijon të cilat janë përlllogaritur për tju përgjigjur nevojave dhe objektivave të Drejtorisë së ndërgjegjësimit Publik dhe promovimit të Shërbimeve për periudhën 2025-2026.

- Gjatë zhvillimit të aktiviteteve dhe eventeve të rëndësishme të organizuara nga Drejtorja e Ndërgjegjësimit Publik dhe Promovimit të Shërbimeve, janë pjesë thelbësore edhe materialet promociionale të cilat përfshijnë elementë të ndryshëm të cilët përdoren kryesisht për aktivitete, evente, promovime si dhe në funksion të delegacioneve të cilat vizitojnë portin. Për vitin 2025 vlera e parashikuar ka mbetur e njëjtë me atë të vitit 2024. **Shtypshkrime për komunikimin, promovimin dhe pritjet zyrtare propozohet të mbulojnë Vlerën prej 1,400,000 lekësh.**


- **Abonime vjetore në gazeta dhe revista kombëtare dhe ndërkombëtare.** Si pjesë konsistente e detyrave funksionale të Sektorit të Komunikimit me median dhe Publikun, përditësimi i informacionit dhe transparenca mbi këtë të fundit mbeten objektivi thelbësor në realizimin e këtyre detyrave. Për rrjedhojë furnizimi me informacionin më të fundit si dhe vijimësia e përditësimit dhe zhvillimeve në kohë reale dhe në koherencë me të gjitha mediat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare mbi çështjet ekonomike dhe sociale, analizat dhe lajmet më të rëndësishme mbi industrinë detare, risitë infrastrukturore të lidhura me të etj por edhe profileve me ndikim në projektet dhe investimet në transportin detar sic është kompleksi i ri portual Durrës-Porto Romano, është konstatuar nevoja për abonimin në disa nga revistat dhe gazetat kombëtare dhe ndërkombëtare me tirazh dhe influencë të lartë në funksion të sa më lart citohet, për të cilat propozohet të dedikohet **një fond prej 400,000 lekë (ALL).**

<p>Autoriteti Portual Durrës DURRËS PORT AUTHORITY</p> 	PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT		
	KËRKESË PËR INVESTIM/ SHPENZIM		
Kodi Nr.: P.180-F.01	Versioni: 1	Data Efektive: 24.06.2024	Faqe 3 / 4

Aktivitetet e Përvitshme në kuadër të “World Maritime Day” 30 shtator 2025. Duke marrë në konsideratë angazhimin dhe gjithëpërfshirjen në organizimin dhe eventet e përvitshme të aktiviteteteve në kuadër të “Ditës Botërore të Detarisë”, e cila tashmë është kthyer në një traditë të APD-së ndër vite me organizimin e Konferencave Ministeriale, Javës së dedikuar aktiviteteve dhe eventeve të Detarisë, etj... “Dita Botërore e Detarisë” është një rast për të mobilizuar vullnetin politik dhe mekanizmat e bashkëpunimit rajonal në funksion të zhvillimit të qendrueshëm të transportit detar dhe ndërlidhjes infrastrukturore në Europën Jug-Lindore, veçanërisht në hapësirën Adriatiko-Joniane.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti Portual Durrës, janë të angazhuar për ta kthyer sektorin detar në një shtyllë të zhvillimit të qendrueshëm ekonomik të vendit, përmes investimeve në infrastrukturën e Porteve si qendra logjistike rajonale. Si një ditë e cila shënjon sektorin detar dhe celebrimet ndërkombëtarisht, në partneritet dhe me mbështetjen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Komunitetit të Përhershëm të Transportit bashkëorganizojmë çdo vit një sërë aktivitetesh në kuadër të **“World Maritime Day 2024”** me financim të Autoritetit Portual Durrës me një **Vlerë prej 3,000,000 lekë (ALL)**.

- Në Autoritetin Portual Durrës ndër vite është krijuar tashmë një traditë e mirë, e cila në analogji me të gjithë institucionet shtetërore, bashkitë por edhe kompanitë private, me rastin e festave të fundvitit të përgatisë dekorin dhe atmosferën festive. Kjo është e rëndësishme edhe për krijimin e një atmosfere të ngrohtë dhe familjare për punonjësit e kompanisë sonë. Për rinovimin e dekorit gjatë festave të fundvitit, propozohet ti kushtohet vëmendje e veçantë dekorit të institucionit në hyrjet kryesore të godinave si dhe parashikohet që për këtë zë të dedikohet për festat e fundvitit një **Vlerë prej 100,000 lekësh** në buxhetin e vitit 2024.
- Pjesëmarrja në panaire si brenda dhe jashtë vendit është pjesë integrale e politikave tona promovuese dhe marketuese. Nga përvoja e deritanishme, APD merr pjesë në të paktën dy panaire kombëtare, që kanë lidhje me industrinë, logjistikën dhe transportin detar. Gjithashtu, kemi qënë pjesëmarrës ndër vite në Panaire ndërkombëtare si ai i Kosovës, Maqedonisë, “Fiera del Levante” në Bari Itali, etj. Kështu, në funksion të këtyre përfaqësive në panairot kombëtare dhe ndërkombëtare është përlllogaritur një **Vlerë prej 1.000.000 lekësh**.

	PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT		
	KËRKESE PËR INVESTIM/ SHPENZIM		
Kodi Nr.: P.180-F.01	Versioni: 1	Data Efektive: 24.06.2024	Faqe 4 / 4


- **Protokolli i pritje-përcjellje (kafe, ujë, drekë), me Vlerë 1,000,000 lekë.** Duke qënë se Sektori i Aktiviteteve dhe Eventeve, ka në fokus organizimin e takimeve zyrtare të APD-së, me partnerë vendas dhe të huaj, lind nevoja edhe për të patur në dispozicion elementët më të nevojshëm për këto organizime, si kafe, ujë apo edhe dreka zyrtare.
- **Publikime, stampim, online, digjitale, në funksion të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm.** Në traditën e Autoritetit Portual, në kuadër të investimeve një element i rëndësishëm promovues kanë qënë materialet me natyrë informuese dhe promovionale, të cilat përfshijnë shërbime publikimi në media dhe online, stampimi, digjitale që realizohen në raport me veprimtarinë portuale, vlerat e APD, masterplanin, investimet, projektet zhvillimore, risitë, inovacionin, strategjitë, digjitalizimi, automatizimi i proceseve dhe zhvillimet më të fundit që implementohen në Portin e Durrësit në funksion të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit si dhe në përmbushje të detyrimeve mbi të drejtën e informimit qofte atij publik dhe të medias. Kështu, në funksion të përditësimit dhe informimit të gjerë dhe koherent mbi këto të fundit, lind nevoja për realizimin e projekteve dhe materialeve audio-vizive dhe të shkruara të cilat pasqyrojnë të gjitha iniciativat dhe projektet e parashikuara rishtazi për një prezantim transparent, dinjitoz dhe në kohë të tyre, angazhim ky i cili është parashikuar të ketë një **Vlerë prej 800,000 Lekë (ALL)**

Në referencë të kërkesave të lartcituara, Drejtoria e Ndërgjegjësimit Publik dhe Promovimit të Shërbimeve, parashtron nevojën për realizimin e Plan Biznesit të vitit 2024, një fond total të parashikuar në vlerën 7,700,000

Përgjegjës Njësie:

Drejtore Drejtorie:

Drejtore Divizioni:



DREJTORIA E BASHKEPUNIMIT NDERKOMBETAR
DHE CEMA

 Autoriteti Portual Durrës DURRËS PORT AUTHORITY	PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT		
	KËRKESË PËR INVESTIM/ SHPENZIM		
Kodi Nr.: P.180-F.01	Versioni: 1	Data Efektive: 24.06.2024	Faqe 1 / 9

Nr. 2835 Prot.
I BRENDSHËM

Durrës më, 31.12.2024

Objekti: Mbi parashikimin e fondeve të Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe CEMA për Plan Biznesin për periudhën 2025-2026.

Fondi i parashikuar:

1. Shpenzime Standarte:	9,693,420
2. Shpenzime të Rimbursueshme nga Projektet me financim të BE	85,304,070
Buxheti total	94,997,490

Qëllimi dhe Argëtimi:

Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe CEMA, ka në përbërje të saj 2 Njësi:


- Njësia e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
- Njësia e Formimit Profesional

Në zbatim të UB. Nr. 412, dt. 7.2.2024, "Mbi hartimin e Plan Biznesit tre vjeçar 2024 – 2026 të Autoritetit Portual Durrës" si dhe bazuar në Rregulloren Organizative të APD-së, Rregulloren e Qendrës së Ekselencës për Çështjet Detare miratuar me VKD Nr. 8 Nr, datë 15/07/2021, si dhe kërkesat e 2 Njësive, Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe CEMA ka përgatitur këtë Relacion duke dhënë një informacion të plotë për çdo shpenzim të parashikuar për vitin 2025

SHPENZIMET

1 - SHPENZIMET STANDARTE 2025 është buxheti vjetor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe CEMA dhe tregon vetëm fondet shtetërore buxhetore të APD. **Buxheti per Shpenzimet Standarte per 2024 ka qene 11,043,000 lekë.**

Nr	Njësia	DREJTORIA E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR & CEMA Shpenzimet standarte per 2025	Shuma		
			PLAN		
			orë mësim	pagesa orë	Kosto




	PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT		
	KËRKESE PËR INVESTIM/ SHPENZIM		
Kodi Nr.: P.180-F.01	Versioni: 1	Data Efektive: 24.06.2024	Faqe 2 / 9

1	NJFP	PAGESA PËR LEKTORËT "KURS PËR VINÇJER PORTUAL"	522	1,500	783,000
2	NJFP	PAGESA PËR LEKTORËT "KURS PËR REACH STACKER"	265	1,500	397,500
3	NJFP	PAGESË LEKTORËSH PËR TRAINIME TË NDRYSHME ME PAGESË (Anglishte Biznesi, E drejte Detare, The Standards of Training Certification and Watchkeeping, etj)	200	1,500	300,000
A - Shpenzime ZHVILLIM I KURSEVE PROFESIONALE ME PAGESË					1,480,500
4	NJFP	Pagesë për Lektorë të Jashtëm (UNIV POLITEKNIK TIRANE / UAMD)			300,000
5	NJFP	Pagesë për Lektore të Brendshme nga APD (trainime të ndryshme)			250,000
6	NJFP	Programi i Specializimeve me pagesë për 10 studentë (Dhjetor 2024 - Mars 2025)	40	58,823	2,352,920
7	NJFP	Trainime për stafin 4 DIVIZIONET APD			1,500,000
B - Shpenzime TRAINIME PËR STAFIN APD					4,402,920
8	NJBN	Pagesë vjetore Organizata AIVP Kursi Euro/Leke 1/100	€ 2,000	100.0	200,000
9	NJBN	Pagesë vjetore Organizata IAPH Kursi Euro/Leke 1/100	€ 4,000	100.0	400,000
10	NJBN	Pagesë vjetore Organizata ESPO Kursi Euro/Leke 1/100	€ 15,000	100.0	1,500,000
11	NJBN	Pagesë vjetore Organizata MEDPorts Kursi Euro/Leke 1/100	€ 4,000	100.0	400,000
12	NJBN	Pagesë vjetore Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Durrës			60,000
13	NJBN	Pagesë vjetore Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë France Shqipëri CCI Kursi Euro/Leke 1/100	€ 500	100.0	50,000






<p>Autoriteti Portual Durrës DURRËS PORT AUTHORITY</p>	<p>PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT</p>		
	<p>KËRKESE PËR INVESTIM/ SHPENZIM</p>		
<p>Kodi Nr.: P.180-F.01</p>	<p>Versioni: 1</p>	<p>Data Efektive: 24.06.2024</p>	<p>Faqe 3 / 9</p>

14	NJBN	Buxhet për pjesmarrje ne Konferenca Ndërkombëtare (Participation Fee)	€ 5,000	100.0	500,000
C - PAGESA VJETORE ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE					3,110,000
15	CEMA	Pagesë për studjues për kërkime dhe botime - Observatori i Logjistikës dhe i Ekonomisë Detare DATA LAB	0		350,000
16	CEMA	Pagesë për blerje dhe ndëtim website - Observatori i Logjistikës dhe i Ekonomisë Detare DATA LAB			100,000
17	NJFP	Fond për printimin e dëshmime të aftësisë profesionale dhe dëshmime te tjera (kartoni dhe shërbim printimi)	500	500	250,000
D - SHPENZIME TË TJERA					1,000,000
Shpenzime Buxheti Standart 2025					9,693,420

A - SHPENZIME KURSE PROFESIONALE ME PAGESË.

Pika 1 – Për vitit 2025 kemi planifikuar zhvillimin e disa kurseve profesionale ne ambjentet e APD. Kursi i parë do jetë: **VINÇJER PORTUAL**. Bazuar ne Kurrikulat ekzistuese te APD, kursi zgjat 6 muaj dhe përfshin praktikë dhe teori. Për këtë kurs ka patur interes nga publiku. Pagesa për person do jetë: 72,000 lekë, prandaj dhe neve kemi parashiuar per 2025:

Shpenzim i parashikuar: 550 orë leksion * 1,500 lekë pagesë / orë = 783,000 lekë

Pika 2 – Kursi i dytë: **STIVUES KONTEINERËSH (REACH STACKER)**. Ky Kurs nuk është zhvilluar asnjëherë më pare nga CEMA. Por Bazuar ne Kurrikulat ekzistuese te APD është parashikuar:

Shpenzim i parashikuar: 265 orë * 1,500 lekë pagesë / orë = 397,500 lekë



	<p>PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT</p>		
	<p>KËRKESË PËR INVESTIM/ SHPENZIM</p>		
<p>Kodi Nr.: P.180-F.01</p>	<p>Versioni: I</p>	<p>Data Efektive: 24.06.2024</p>	<p>Faqe 4 / 9</p>

Pika 3 – Kurse me pagesë të organizuara nga CEMA, në bashkëpunim më Lektorë dhe ekspertë nga UAMD, APP, DOGANAT, DPD, etj. Kurset janë: **Anglishtja e Biznesit**, Hyrje programet e Inteligjencës Artificiale, etj. **KARTA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË**, etj.

Shpenzim i parashikuar: 200 orë * 1,500 lekë/ orë = 300,000 lekë

B – SHPENZIME PËR TRAINIMET PËR STAFIN E APD

Pika 4. Pagesa për Lektorë të Jashtëm: Duke patur parasysh ekspertizën të stafit të Inxhinjerisë Mekanike të Universitetit Politeknik në Tiranë, në lidhje me Kurset profesionale të APD, ose ekspertizën e Prokuruesve Publikë të ndryshëm të cilët zhvillojnë kurse të ndryshme me pagesë, është përlogaritur një shumë prej **300,000 lekësh** për këtë kategori.

Pika 5 – Pagesa për Lektorë të Brendshëm nga APD. Duke patur parasysh burimet njerëzore të APD, ku ka staf shumë profesionist dhe me ekperience të cilët mund të kryejnë kurse të ndryshme, është përlogaritur një shumë prej **250,000 lekësh** për këtë kategori.

Pika 6 – Programi i Specializimeve me Pagesë. Bazuar në Relacionin Informues Nr. 2156 Prot, date 01.10.2024 si dhe UB Nr 1157/1 Prot, datë 21.05.2024, u përzgjedhën 10 studentë, të cilët, që prej muajit Tetor 2024 janë duke kryer një specializim me pagesë mujore prej 58,823 lekë për një periudhë 6 mujore pranë APD. Për këtë program parashikuan në total (10 studentë * 6 muaj * 58,823 lekë = 3,529,380 lekë. Nga keto gjatë 2024 u shpenzuan pagesa për 2 muaj (Tetor, Nëntor) shuma: 705,876. Për vitin 2025 kemi parashikuar pagesen për 4 muajt e mbetur (Dhjetor 2024, Janar, Shkurt, Mars 2025), shuma prej: **2,352,920 lekësh**.

Pika 7 – Pagesa për trainime për stafin 4 DIVIZIONET APD. Ky është një nga zërat kryesorë të Buxhetit të CEMA-s. Është një proces që bazohet në mbledhjen e kërkesave të stafit të APD për trainim për vitin 2025. Parashikojmë të përfundojë në Dhjetor 2024. **Është parashikuar nga 500,00 lekë për secilin nga 5 ndarjet administrative të APD (Drejtoritë e tjera + 4 Divizionet)**, kjo shumë është përlogaritur në **2,500,000 lekë**.

C – SHPENZIME VJETORE PËR ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Shpenzimet për anëtarësime në organizata ndërkombëtare të porteve dhe industrisë së transportit detar është përlogaritur në vlerën **3,160,000 lekë**. APD aktualisht është anëtare me të drejta të plota në 3 Organizata Ndërkombëtare në fushën e transportit detar dhe logjistikës, që janë IAPH, MEDPorts dhe AIVP. Që prej vitit 2021 APD ka fituar statusin e Anëtarit Vëzhgues në ESPO. Po ashtu APD është anëtar tek Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë franceze CCI si dhe tek Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës. Kursi i këmbimit valutor (1 Euro = 100 Lekë)



	PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT		
	KËRKESË PËR INVESTIM/ SHPENZIM		
Kodi Nr.: P.180-F.01	Versioni: 1	Data Efektive: 24.06.2024	Page 5 / 9

Kursi i këmbimit valutor bazuar në kursin e Bankës së Shqipërisë së datës 7.11.2024: 1Euro = 98.00 Lekë, por për lehtësi llogaritje është përdorur Kursi i Këmbimit Euro/ Lek 1/100. Më poshtë një informacion rreth sejcilës organizatë.

Pika 8. APD është anëtar i AIVP – Association Internationale des Villes Portuaires, e njohur zyrtarisht si organizata që përfaqëson qytet portet në industrinë e porteve në mbarë botën, e cila e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim me një sërë organizatash të tjera si: IAPH, ESPO, i IMO, ILO, ECOSOC, UNCTAD etj. AIVP është e vetmja organizatë ndërkombëtare që për 25 vjet, ka sjellë së bashku të gjithë aktorët e zhvillimit publik dhe privat në qytetet - porte. AIVP ka mbështetur anëtarët në zbatimin e strategjive të reja që i lejojnë ata për tu përballur me ndryshimet që ndikojnë në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor në qytetet porte dhe në integrimin urban. **Pagesa vjetore është e ndryshme për çdo anëtar, por pagesa vjetore për Autoritetet Portuale përlllogaritjet bazuar në Cargo Volumes vjetore, prandaj është teknikisht e pamundur të parashikohet pagesa për vitin pasardhës.** Pagesa për 2024 ka qenë 1,569 Euro, prandaj dhe për 2025 kemi parashikuar shumë prej: **200,000 Lekë (2,000 Euro Membership Fee).**

Pika 9. APD është anëtar i IAPH - International Association of Ports and Harbors që nga viti 2000. Kjo Organizatë NGO me Qendër ne Tokio, ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1955 dhe në të janë anëtaresuar mbi 200 porte, duke përfaqësuar 85 vende të Botës. Kjo organizatë ka statusin e NGO, organizon evente, konferenca, forume të ndryshme që kanë lidhje me biznesin portual, transportin detar, logjistikën, teknologjinë, trajnime, etj. Pagesa vjetore për anëtarësim në IAPH çdo vit llogaritet si:

- a. **Bordi i IAPH ka vendosur që pagesa vjetore e anëtarëve të indeksohet bazuar në Indeksin e Çmimeve të Konsumit (CPI Consumer Price Index) të Japonisë dhe Belgjikës, vendet ku janë vendosur njësitë operative të IAPH.** (*IAPH Board decided to introduce an indexation of membership dues, linked to the Consumer Price Index (CPI) of Japan and Belgium, the countries where our operational units are located*),
- b. **Special Draëing Right bazuar në volumet e tonazhit vjetor të sejcilit anëtar.**

Prandaj është teknikisht e pamundur të parashikohet pagesa për vitin pasardhës. Pagesa për 2024 ka qenë 2,904 Euro, dhe duke parë trendin rritës të transportit detar konteinerik në APD për 2025 si dhe shpenzime potenciale për Pagesa për Pjesmarrje (Participation Fee) kemi parashikuar shumë prej: **400,000 Lekë (4,000 Euro Membership Fee).**

Pika 10. ESPO - The European Sea Ports Organisation (Organizata e Porteve Detare Europiane), me qendër në Bruksel është krijuar në vitin 1993. ESPO është një zë i rëndësishëm i porteve në BE, përfaqëson, promovon interesat dhe vlerat e përbashkëta para institucioneve

	PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT		
	KËRKESË PËR INVESTIM/ SHPENZIM		
Kodi Nr.: P.180-F.01	Versioni: 1	Data Efektive: 24.06.2024	Faqe 6 / 9

evropiane dhe politikë-bërësve, ndihmon anëtarët e saj në implementim më të mirë të nismave politike me rëndësi për sektorin. ESPO gjithashtu është e angazhuar në një dialog të vazhdueshëm me të gjithë aktorët evropianë në sektorin e portit dhe detar. APD që prej vitit 2021, mban statusin e **Anëtarit Vëzhgues (Observer Member)** në këtë organizatë. **Tek kjo orgnizatë pagesa vjetore do jetë gjithmonë në rritje. Pagesa vjetore për 2024 ka qenë 14.000 Euro prandaj dhe për 2025 kemi parashikuar shumë prej: 15.000 Euro / 1,500,000 Lekë, vetëm si Membership Fee.**

Pika 11 – APD është anëtar i **MEDPorts Association**, pasi kemi vlerësuar punën dhe performancën gjithnjë në rritje të MEDports Association, ndaj dhe kemi marrë iniciativën për t’ju bashkuar komunitetit të anëtarësisë së kësaj organizate të mirënjohur. **Pagesa vjetore për këtë organizatë është fikse: 4,000 Euro. Kemi përlogaritur shumë 400,000 lekë.**

Pika 12 – **Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Durrës**, pagesa vjetore llogaritet çdo vit në bazë të xhiros vjetore të subjektit ku shuma max është 10.000 leke dhe shuma maksimale 60,000 lekë, informcaion të cilin ia kërkojnë çdo vit zyrtarisht çdo anëtar: Për 2025 është parashikuar shuma e njëjtë me vitin e kakuar **60,000 lekë.**

Pika 13. CCI- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Francë – Shqipëri është një entitet jo tregtar me personalitet juridik, e cila ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. APD është anëtar që prej vitit 2020. Në përmbushje të detyrimeve të anëtarësimit kundrejt Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Francë Shqipëri, është kryer pagesa respektive për anëtarësimin bazuar në kuotimin e anëtarësimit sipas termave të përzgjedhura nga Autoriteti Portual Durrës gjatë procedurës së aplikimit për vitin 2020. APD është anëtar tek Kategoria « Klubi i Biznesit », **prandaj dhe pagesa vjetore e anëtarësimit është shuma fikse prej 500 Euro (50,000 Lekë) .**

Pika 14. Nga anëtarësimi në Organizatat Ndërkombëtare rrjedh edhe detyrimi për të marrë pjesë fizikisht të paktën 1 herë në vit në eventet kryesore. **Shpenzime për pagesat e pjesmarrjes në aktivite ndërkombëtare. (Participation Fee) 500,000 Lekë (5,000 Euro)**

D – SHPENZIME TË TJERA

Pika 15 - Observatori i Ekonomisë dhe Logjistikës Detare - DATA LAB. Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit mbi krijimin e Observatorit të Logjistikës Detare dhe Zinxhirëve të Prodhimit DATA LAB, ku APD ka detyrim të sponsorizojë të gjitha shpenzimet është menduar që gjatë 2025 të realizohen kërkime akademike profesionale në fushat e logjistikës dhe ekonomisë detare, të kryhen, dhe të publikohen nën logon e OMEL. Për këtë qëllim është përlogaritur një **Buxhet vjetor prej 350,000 lekë.**






	<p>PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT</p>		
	<p>KËRKESË PËR INVESTIM/ SHPENZIM</p>		
<p>Kodi Nr.: P.180-F.01</p>	<p>Versioni: 1</p>	<p>Data Efektive: 24.06.2024</p>	<p>Faqe 7 / 9</p>

Pika 16 - Krijim/blerje faqen website Observatori i Ekonomisë dhe Logjistikës Detare - DATA LAB. Po ashtu bazuar Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, Neni 3 Roli dhe detyrat e palëve nënshkruese të Memorandumit, pika 8, APD ka detyrim “të angazhohet të ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme logjistike dhe financiare për mbarëvajtjen e platformës”, është parashikuar një shumë prej 100,000 lekësh për krijim/blerje faqen ebsite me logon OELD Data Lab. **Shpenzimet për krijim/blerje faqen website: 100,000 lekë**

Pika 17 - Fond për printimin e dëshmive të aftësisë profesionale dhe dëshmive te tjera (kartoni dhe shërbim printimi) Fond i parashikuar për printim me karton të trashë të të gjithë dëshmive / certifikatave të aftësisë profesionale. **Shuma 250,000 lekë.**

2 – SHPENZIME TË RIMBURSUESHME NGA PROJEKTET ME FINANCIM TË BE

Tek planifikimi i shpenzimeve te rimbursueshme nga Projektet me Financim te BE, baza është gjithmone buxheti ne Euro. Më poshtë gjeni Tabelat me parashikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve të Rimbursueshme.

Shuma është përlloragitur: **868.500 Euro** ose ekuivalent **85.304.070 Lekë**, bazuar në Kursin e Këmbimit të BSH datë 12 Dhjetor 2024 të ndarë në 2 tabela, si më poshtë:

INVESTIME	Shuma e parashikuar (Euro)	Shuma e parashikuar (Leke)
Zbatimi i planit pilot: Blerja dhe instalimi i paneleve diellore - RENEWPORT	€ 83,000	8,152,260 Lekë
Zbatimi i planit pilot: Blerja dhe instalimi i paneleve diellore - ADRIREC	€ 98,000	9,625,560 Lekë
Pajisjet laboratorike të nevojshme për testimin e teknikave inovative në Portin e Durrësit (WP3): trajtimi i ujit (pluhuri dhe vaji) sipas teknikave të reja me burim në WP3 - TREASURE	€ 80,000	7,857,600 Lekë
Software PCS – SA CONNECTIVITY	€ 350,000	34,377,000 Lekë
Equipment (hardware)Port Community System (PCS) - SA CONNECTIVITY	€ 150,000	14,733,000 Lekë
TOTAL	761,000.00 €	74,745,420 Lekë

	PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT		
	KËRKESE PËR INVESTIM/ SHPENZIM		
Kodi Nr.: P.180-F.01	Versioni: 1	Data Efektive: 24.06.2024	Page 8 / 9

SHPENZIME	Shuma e parashikuar (Euro)	Shuma e parashikuar (Lekë)
Ekspert i jashtem: *Paketa e Instrumenteve të Testimit & Studim paraprak për planin e veprimit- RENEWPORT	10,000 €	982,200 Lekë
Kosto per Asistence teknike (angazhimi i ekspertit të jashtëm) TREASURE	10,000 €	982,200 Lekë
Studim paraprak per "Kostot që lidhen me burimin e teknikave të reja në WP3, për trajtimin e ujit " TREASURE	20,000 €	1,964,400 Lekë
Studim paraprak për planin e veprimit - SA CONNECTIVITY	18,200 €	1,787,604 Lekë
Organizim eventesh dhe takimesh TREASURE	3,000 €	294,660 Lekë
Prodhim materialesh promocionale TREASURE – 2500 € SA CONNECTIVITY - 9500 €	12.000 €	1,178,640 Lekë
Equipment: 3 laptop – ADRIREC 5.000 € printer, kamera – ADRIREC 4.300 €	9.300.00 €	913, 446 Lekë
Travel and accommodation Te 4 projektet SA CONNECTIVITY 6.000 € ADRIREC 1.500 € TREASURE 5.500 € RENEWPORT 12.000 €	25,000.00 €	2,455,500 Lekë
TOTAL	107,500.00 €	10,558,650Lekë

Njësia e Bashkëpunimit Ndërkombëtar menaxhon dhe ndjek zbatimin e aktiviteteve të projekteve që ka në zbatim. Të gjitha aktivitetet e mesipërme janë parashikuar për tu zbatuar përgjatë vitit 2025. Rimbursimi i fondeve të shpenzuara bëhet pasi janë realizuar dhe çertifikuar nga programet e financimit të gjitha shpenzimet. Aktivitetet e listuara më sipër u përkasin katër projekteve të financuara nga tri programe të ndryshme financimi.

Përfshirja e këtij buxheti në Biznes Planin e vitit 2025:




Autoriteti Portual Durrës DURRËS PORT AUTHORITY	PROCESI I HARTIMIT TË PLAN BIZNESIT		
	KËRKESE PËR INVESTIM/ SHPENZIM		
Kodi Nr.: P.180-F.01	Versioni: 1	Data Efektive: 24.06.2024	faqe 9 / 9

- a) bën të mundur përthithjen e fondit për rimbursimin e shpenzimeve për udhëtime, akomodim, dieta,
- b) bën të mundur përthithjen e fondit për rimbursimin e shpenzimeve për pritje, printime etj.

*Kursi i këmbimit valutor bazuar në kursin e Bankës së Shqipërisë së datës 12 Dhjetor 2024

(1 Euro = 98.22 Lekë)

TË ARDHURA

Gjatë vitit 2025 CEMA parashikon të krijojë këto të Ardhura:

Të Ardhura Kursi Vinçjer Portual: 10 kursantë * 72,000 lekë = 720,000 lekë (me TVSH)

Të Ardhura Kursi: STIVUES KONTEINERËSH 10 kursantë * 72,000 lekë = 720,000 lekë (me TVSH)

Te Adhurat CEMA viti 2025	Shuma në Lekë
Të Ardhura nga Kursi Vinçjer Portual	720,000
Të Ardhura nga Kursi STIVUES KONTEINERËSH	720,000
Totali	1,440,000

Përgjegjës Njësie: znj. Serena Kovaçi



Përgjegjës Njësie: znj. Marinela Kërçuku

Drejtor Drejtorie: z. Endrit Pollo

